



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Mësuesi për  
“Arsimin Parashkollor”**

**ofruar nga**

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


- 1. Dr. Pranvera Puka/Kraja**
- 2. Prof.Asoc. Dr Robert Gjedia**

**Prill 2023**



**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor në Mësuesi për “Arsimin Parashkollor” ofruar nga**  
**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Metodologjise së Mësimdhënies
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “ Arsim Parashkollor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 414 datë 12.11.1991 “Për hapjen e Universitetit të Elbasanit – Aleksander Xhuvani”
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM Nr. 821 datë 05.12.2007 “Për krijimin e disa Njësive kryesore, Fakulteteve te Universitetit “Aleksandër Xhuvani”
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	32
19	Komente / të tjera:	-





## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua duke u mbështetur në dy elemente kryesorë, si: Shqyrtimi dhe analiza e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB dhe evidencat përkatëse) të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (në vijim UE) dhe së dyti sipas aktiviteteve të realizuara konform agjendës së miratuar nga dy institucionet ASCAL dhe UE. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet e evidentuara nga analiza e procesit të vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë me emërtesë Bachelor në “Arsim Parashkollor” (marrë këtë emërtim në vitin 2010), program i cili është hapur për herë të parë në UE në vitin akademik 1995-1996 me emërtesë “Mësues për ciklin Parashkollor” dhe me kohëzgjatje 3-vjeçare.

Programi ofrohet prej Departamentit të Metodologjisë së Mësimdhënies (DMM) pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit (FSHE), fakultet i hapur dhe i riorganizuar sipas VKM Nr. 821 datë 05.12.2007 “Për krijimin e disa Njësive kryesore, Fakulteteve të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”.

Me anë të VKM Nr. 414 datë 12.11.1991 “Për hapjen e Universitetit të Elbasanit – Aleksander Xhuvani” u bë e mundur kalimi i këtij institucioni nga Institut i Lartë Pedagogjik në Universitet, me emërtesën që mban edhe sot Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Aktualisht, programi Bachelor në “Arsim Parashkollor” është program i ciklit të parë të studimeve universitare. Ky program synon të formojë mësues për arsimin parashkollor. Ai përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Në përfundim të ciklit të studimit tre vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare “Diplomë Bachelor” në “Arsim Parashkollor”.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program në tre vitet e fundit, është:

- Për vitin akademik 2021-2022 është 13 studentë (+ 2 studentë të transferuar)
- Për vitin akademik 2020-2021 është 10 studentë
- Për vitin akademik 2019-2020 është 7 studentë

Gjithsej 32 studentë. Të diplomuar 16 studentë

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Arsim Parashkollor” nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### *Metodologjia e përdorur për realizimin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, nga ana e programin e studimit të ciklit të parë, “Bachelor” në “Arsim Parashkollor”. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga Prof.Asoc.Dr. Robert Gjedia dhe Dr. Pranvera Kraja/Puka dhe gjatë vizitës në institucion ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL Znj. Anilda Beqiraj. Vizitat u realizuan në datat 17 dhe 18 Janar 2023. Për përmbushjen me sukses të këtij vlerësimi të jashtëm, GVJ mori në konsideratë udhëzimet etike dhe metodologjike të bëra me dije përmes trajnimeve paraprake nga specialistë të sektorit përkatës të ASCAL.

*Dokumentacioni ligjor mbi të cilin u mbështet procesi i vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Mësuesi për “Arsim Prashkollor”, në FSHE, të UE-së, është:*

- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM Nr. 414 datë 12.11.1991 “Për Vendimin e hapjes së Universitetit të Elbasanit-Aleksandër Xhuvani”;
- VKM nr. 821 datë 05.12.2007 "Per krijimin e disa Njësive kryesore, Fakulteteve të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", (krijimi i Fakultetit të Shkencave të Edukimit);
- VKM nr. 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”;
- VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.
- VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, date 24.1.2018”.
- Statutin e UE dhe Rregulloret në UE.
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

### ***Aktivitetet kryesore të realizuara***

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete duke përfshirë analizën e të dhënave parësore dhe dytësore si dhe vizitat në ambjentet e brendshme të UE dhe FSHE-së.

**Analiza e të dhënave parësore** është bazuar nga të dhënat e marra nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe evidencat përkatëse për programin e studimit të ciklit të parë, “Bachelor” në “Arsim Parashkollor” (Nëntor 2022), i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit.

**Analiza e të dhënave dytësore** u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara në institucion, përkatësisht:




- Takim me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të Departamentit që mbulon programin e studimit;
- Takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm;
- Takim me stafin akademik që angazhohet në këtë program;
- Takim me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave;
- Takim me studentë të këtij programi;
- Takim me Përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Takim me përfaqësues të Zyrës së Projekteve për Kërkim;
- Vizitë në Sekretarinë mësimore;
- Vëzhgim i mjediseve mësimore dhe në bibliotekë;
- Takim përfundimtar me Përgjegjës të Departamentit;

Qëllimi i këtyre takimeve ishte realizimi i bisedave që synonin mbledhjen e informacioneve të domosdoshme lidhur me zbatimin e këtij programi, ballafaqimin e tyre me gjetjet dhe konkluzionet e raportit të vlerësimit të brendshëm. Pjesë e metodologjisë së ekipit të vlerësimit të jashtëm, ishte edhe:

**Vëzhgimi i mjediseve mësimore** në dispozicion të programit të studimit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm, si: auditorë, laboratorë të pikturës, të muzikës, të informatikës, të sekretarisë, si edhe të mjediseve të bibliotekës së FSHE-së dhe të UART-it.

Mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime, nga puna në ekip e vlerësuesve të jashtëm me RVB si dhe nga evidencat përkatëse, është hartuar ky raport i vlerësimit të jashtëm.





# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Arsim Parashkollor”

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>	
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Universitetit të Elbasanit (UE) rezulton se ky institucion ofron programe studimi që janë në përputhje me interesat kombëtare. E gjithë veprimtaria e tij bazohet në legjislacionin shqiptar<sup>1</sup> në përgjithësi dhe si dhe në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon marrëdhëniet në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor përmes dokumenteve bazë rregullatore të institucionit si: Statuti i UE-së; Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2024; Plani strategjik i zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.</p> <p>Bazuar në nenin 2 të Statutit të UE, në të cilin theksohet se, misioni i këtij institucioni është që <i>“të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencetarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; dhe “të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar”, deklarojmë se institucioni synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare të programeve të tij të studimit.</i></p> <p>Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Arsim Parashkollor” i referohet nivelit 6 të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Rezulton se Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor (BMAP) mbështetet në qëllimet dhe misionin e UE-së<sup>2</sup>, si dhe në dokumentet rregullatore të brendshme të tij.<sup>3</sup></p> <p>Misioni i UE është <i>“të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit”</i>. Universiteti i Elbasanit ka një histori të shquar të përvojës arsimore në vendin tonë. UE është vazhdues i Institutit të Lartë Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani" (ILP) themeluar me 1971, i cili ishte vazhdues i drejtpërdrejtë i Shkollës Normale të Elbasanit, i pari institucion kombëtar i përgatitjes së mësuesve në Shqipëri, themeluar më 1909.<sup>4</sup></p> <p>Si i tillë, ky institucion ka një kontribut të shquar në fushën e kulturës dhe traditës arsimore në vend dhe programet e tij të studimit mbështeten në fushën e veprimtarisë së tij, ku si objektivi kryesor është <i>“formimi i profesionistëve të aftë për të përballur sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave</i></p>

<sup>1</sup> Ligji nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

<sup>2</sup> Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2024, fq. 7. Evidenca 1.3; Statuti UE, neni 2. Evidenca 1.1.

<sup>3</sup> Rregullore e studimeve UE, Evidenca 1.2; Rregullore e programit të studimit BMAP, Evidenca 1.8.

<sup>4</sup> Statuti UE, Neni 1, Pika 3.



	<i>humane, natyrore, ekonomike, të edukimit si dhe shkencave mjekësore e teknike.</i> ” <sup>5</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së Programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor themi se ky program ka për mision <i>“të përgatisë mësues për arsimin parashkollor të aftë për të zhvilluar veprimtarinë mësimore në institucionet e arsimit parashkollor; profesionistë të zotë në mësimdhënie me interes për dijen dhe kërkimin shkencor”</i>.<sup>6</sup></p> <p>Në Strategjinë e zhvillimit institucional 2020-2024, theksohet se <i>“Objektivi kryesor i UE-së është të formojë profesionistë të aftë për të përballur sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave humane, natyrore, ekonomike, të edukimit si dhe shkencave mjekësore e teknike.”</i><sup>7</sup></p> <p>Në Statutin e UE neni 2, citohet se misioni i UE mbi të cilat hartohen programet e studimit është: <i>“të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend.”</i><sup>8</sup></p> <p>Bazuar më sipër, deklarojmë se programi i studimit Ba në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me Strategjinë për zhvillim, Statutin dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike institucionale.</p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Referuar Urdhrit të hapjes të Universitetit të Elbasanit, deklarojmë se UE është një institucion i arsimit të lartë i kategorisë Universitet, i themeluar në 1991.<sup>9</sup> Programi i studimit Ba në Mësuesi për Arsimin Parashkollor ofrohet nga DMM, i cili është njësi bazë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, sipas VKM Nr. 821 datë 05.12.2007<sup>10</sup>.</p> <p>Rezulton se nga shqyrtimi i evidencës së personelit akademik për vitin 2021-2022<sup>11</sup>, DMM përgjegjëse për këtë program studimi ka të angazhuar <b>25 pedagogë efektivë (PAE)</b>, prej të cilëve: 5 pedagogë kanë titullin Prof. Dr.; 8 pedagogë Prof. as. Dr.; 1 pedagog mbajnë titullin “Docentë”, 7 pedagogë kanë gradën Dr.; dhe <b>4 pedagogë me kontratë (PAK)</b>, prej të cilëve: 1 pedagog me titull Prof. as. Dr. dhe 3 asistentë lektorë me Msc.</p> <p>Eksperiencia shumëvjeçare e stafit akademik dhe cilësia e lartë e kualifikimit të tij, dëshmojnë se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit BMAP në fushën e mësuesisë.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të	<p>Programi i studimit BMAP ka si fushë të përgjithshme mësuesinë dhe si fushë specifike, mësuesinë në arsimin parashkollor, ku synon <i>“përgatitjen e mësuesve për arsimin parashkollor të aftë për të zhvilluar veprimtarinë mësimore në institucionet e arsimit parashkollor”</i>. Të dyja këto fusha përputhen plotësisht me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe me atë të Departamentit të Metodologjisë së</p>

<sup>5</sup> Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2024, Objektivat. Evidenca 1.3.

<sup>6</sup> Rregullore e programit të studimit BMAP, Neni 6. Evidenca 1.8.

<sup>7</sup> Strategjia e zhvillimit institucional 2020-2024, fq. 7. Evidenca 1.3.

<sup>8</sup> Statuti UE, Neni 2, Pika b, c.

<sup>9</sup> Urdhri i hapjes UE Evidenca 1.5.

<sup>10</sup> VKM Nr. 821 datë 05.12.2007 “Për krijimin e disa Njësive kryesore, Fakulteteve të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”.

<sup>11</sup> Tabela 6.3 dhe Tabela 7. Stafit akademik për programin e studimit Mësuesi në Arsimin Parashkollor (Viti akademik 2021-2022). Evidenca 1.8.13.



<p>programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Mësimdhënies nga i cili ofrohet ky program studimi.<sup>12</sup> Kjo përputhshmëri evidentohet në të gjithë programet e ofruara nga DMM.</p> <p>Sipas RVB-së, DMM është përgjegjës për 17 programe studimi: 1 Program profesional, 2 Programe Bachelor, 13 Master Profesional dhe 1 Master i Shkencës.</p> <p>Programi i studimit Ba në “Arsim Parashkollor” i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Emërtimi i programit është në koherencë me atë të njësisë bazë dhe kryesore.</p> <p>Megjithëse kodifikimi kombëtar i programeve të studimit, i parashikuar nga dispozitat e nenit 86 të ligjit 80/2015, nuk është kryer akoma nga MAS, konfirmojmë se institucioni ka realizuar kodifikimin e lëndëve të të këtij program studimi.<sup>13</sup></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ deklaron se programi i studimit BA në Mësuesi për Arsimin Parashkollor që ofrohet nga Universiteti i Elbasanit është në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe të Departamentit të Metodologjisë së Mësimdhënies, duke ruajtur vlerat akademike, kulturore dhe kombëtare. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit UE si dhe në Statutin e UE<sup>14</sup> vihet re një ndarje e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, të cilat delegojnë detyrat dhe përgjegjësitë midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore mbulohet nga Departamenti. Po ashtu aty janë të përcaktuara roli i drejtuesit të njësive bazë, përgjegjësit të grupit mësimor sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike.</p> <p>UE për mbarëvajtjen e programit BMAP, siguronte marrëdhënie bashkëpunimi në rang fakultetesh dhe në rang departamentesh. Bashkëpunimi brenda institucionit realizohej ndërmjet Fakultetit të Shkencave Humane dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ndërsa bashkëpunimi brenda njësive kryesore të FSHE-së, me njësitë bazë realizohej me: Departamentin e Psikologjisë, të Edukimit Fizik dhe Sporteve, dhe me Qendrën për Kërkim dhe Zhvillim në Edukim.<sup>15</sup></p>

<sup>12</sup> Rregullore e FSHE. Evidenca 1.7; Rregullore e programit të studimit BMAP, Neni 6, Misioni. Evidenca 1.8.

<sup>13</sup> Kodifikimi i lëndëve në programet e studimit në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Evidenca 1.9.

<sup>14</sup> Rregullore e organizimit dhe funksionimit UE. Evidenca 1.4; Statuti UE. Evidenca 1.1.

<sup>15</sup> Statuti i UE, Neni 7; Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, Evidenca 4.5.



	Analiza e veprimtarisë akademike, ndihmës akademike dhe administrativo-financiare e institucionit, pasqyrohej në analizën vjetore institucionale. <sup>16</sup>			
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UE kishte vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e ndryshme <sup>17</sup> me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor për programin e studimit BMAP. Përmes marrëveshjeve u sigurohej studentëve një formim të plotë profesional. Të gjitha aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyroheshin në Analizën vjetore institucionale (2020-2021).			
<b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga shqyrtimi i RVB-së dhe i dokumentacionit të dorëzuar nga FSHE dhe DMM, deklarojmë se UE ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor. <sup>18</sup> Marrëveshjet e bëra nga UE me ZVA-në Elbasan dhe Bashkinë e Elbasanit ishin ndër marrëveshjet kryesore të cilat u lejonin studentëve të këtij program studimi, të zhvillonin praktikat e tyre profesionale pranë kopshteve të përzgjedhura.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Konfirmojmë se DMM, përgjegjëse e programit të studimit BMAP, përmes mbledhjeve periodike të departamentit dhe raporteve analitike, analizonte të gjithë punën e bërë me institucionet e tjera në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të saj. Kjo analizë evidentonte arritjet pozitive dhe përmirësimet e punës aty ku nevojitej dhe pasqyrohej në analizën vjetore të DMM-së. <sup>19</sup> Po ashtu, një përmbledhje e shkurtër e zhvillimit të marrëveshjeve në kohë të UE me institucionet e tjera paraqitej edhe në Analizën vjetore të FSHE-së. <sup>20</sup>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konfirmon se UE, FSHE dhe DMM sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi të frytshme me institucione shtetërore dhe private, me qëllim formimin e profilit profesional dhe shkencor të studentëve të BMAP. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

### Standardi II.1

**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.**

<sup>16</sup> Analiza vjetore institucionale 2020-2021. Evidenca 1.11.

<sup>17</sup> Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Evidenca 1.12.

<sup>18</sup> Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave. Evidenca 1.13.

<sup>19</sup> Analiza vjetore e DMM. Evidenca 1.8.1.

<sup>20</sup> Analizë vjetore e FSHE (2021-2022), fq. 6. Evidenca 1.8.21.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është i organizuar në lëndë e module me 180 kredite gjithsej, të ndarë në mënyrë të barabartë për secilin vit me nga 60-ECTS, e me kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra). Në përfundim të këtij programi, studenti merr diplomën Bachelor si “Mësues për Arsimin Parashkollor”.</p> <p>Programi i studimit i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është në përputhje me nenet 69-73 të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si edhe me VKM nr.41, datë 24.1.2018 “Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Misioni i programit të studimit BMAP synon përgatitjen e specialistëve të arsimit parashkollor me njohuritë bazë të domosdoshme e integruese mbi metodat dhe parimet shkencore; t’i orjentojë studentët drejt një mësimdhënieje sa më të suksesshme, si edhe kërkimit didaktik dhe pedagogjik në edukim.<sup>21</sup></p> <p>Ky mision arrihet përmes realizimit të lëndëve të tilla formuese si: Gjuhë shqipe, Letërsi për fëmijë; Matematikë elementare; Njohuri mbi natyrën; Njohuri për shoqërinë; Bota sociale e fëmijës; Pedagogji e edukimit familjar; Të mësuarit përmes lojës, etj</p> <p>Ndërsa lëndët, si: Edukim koral dhe Mësim instrumenti; Arti 3-dimensional; Akuarel, Tempera dhe Teknika e loja në art, ofronin kompetenca të avancuara në fushën e artit për studentët e arsimit parashkollor.</p> <p>Referuar Syllabuseve të programit studimit BMAP, deklarojmë se ky program mbështetet gjithashtu në modelet e konfirmuara në nivel evropian dhe më tej, si “Montesori”, “Rexho Emilia” e “Hap pas Hapi”, të cilat janë aplikuar dhe kanë qenë të suksesshme edhe në kontekstin tonë socio-kulturor e edukativ.<sup>22</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Bazuar në Planin mësimor 2022-2025<sup>23</sup>, programi i studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” siguron ndarje të lëndëve mësimore gjithsej për tre vitet akademike, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– lëndë bazë ose të përgjithshme (27 kredite ose 15 %).</li> <li>– lëndë karakterizuese (95 kredite ose 52.77%).</li> <li>– lëndë ndërdisiplinore (24 kredite, ose 13.33%).</li> <li>– lëndë plotësuese (21 kredite ose 11.66%).</li> <li>– detyrime përmbyllëse (6 kredite ose 3.33%).</li> </ul> <p>Sipas Shtojcës nr.1 (Tabela 1) të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, shuma e lëndëve bazë plus lëndët karakterizuese duhet të jetë 70%.</p> <p>Konstatohet se <b>ky kusht pothuajse plotësohet krejtësisht</b> (me 67.77%).</p> <p>Programet specifike të çdo lënde<sup>24</sup> janë bazuar dhe <b>plotësojnë</b> kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, duke përfshirë:</p>

<sup>21</sup> Rregullore e programit të studimit BMAP, neni 6. Evidenca 1.8.

<sup>22</sup> Plani mësimor i programit të studimit BMAP, Evidenca 1.8.2; Syllabuset e programit të studimit BMAP, Evidenca 1.8.3.

<sup>23</sup> Rregullore e FSHE, neni 19, pika 1. Evidenca 1.7.

<sup>24</sup> Syllabuset e programit të studimit BMAP, Evidenca 1.8.3.



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesën përshkruese, tipologjinë e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin, si edhe adresën elektronike të pedagogut.</li> <li>- Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit.</li> <li>- Konceptet themelore, temat e lëndës.</li> <li>- Forma e kontrollit të dijeve, frekuentimi.</li> <li>- Kontrolli i vazhdueshëm, literatura.</li> <li>- Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës.</li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<p>Gjatë analizës së programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, konstatojmë se ai ka të përcaktuara ngarkesën në kredite, në këtë mënyrë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për realizimin e praktikës profesionale, gjithsej 20 ECTS për tre vitet (i ndarë sipas viteve: 3,6 dhe 11 ECTS).</li> <li>- për detyrimet përmbyllëse me provimin përfundimtar me 6 ECTS.<sup>25</sup></li> </ul>
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<p>Deklarojmë se Universiteti i Elbasanit nuk është institucion me status të veçantë. Në Statutin e UE-së, në nenin 1 dhe 2 shkruhet se <i>"Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani" është institucion publik i arsimit të lartë. UE është person juridik publik, që financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme."</i></p> <p>Forma e organizimit të studimeve të Ba në Mësuesi për Arsimin Parashkollor është studime me kohë të plotë dhe pranimi i studentëve dhe financimi i tij bëhet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe të gjithë dokumenteve rregullatore të UE-së.<sup>26</sup></p>
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Sipas analizës së paraqitur në RVB nga Departamenti i Metodologjisë së mësimdhënies, deklarohet se programi BMAP është hapur duke patur një përmbajtje të ngjashme me programet e studimit në të njëjtën fushë me IAL-të e tjera. Por përgjatë viteve, përmbajtja e programeve të studimit BMAP, ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, ku ndryshimet më të mëdha kurrikula i pësoi pas vitit 2016 me hyrjen në fuqi të ligjit për arsimin e lartë, bazuar në nenin 72 dhe 75 për organizimin e programeve të studimit (Ligji Nr. 80/2015). Këto ndryshime bënë që përmbajtja e këtyre programeve ndërmjet IAL-ve të jetë e ndryshme dhe nuk respekton përafërsinë me 70% të tyre.<sup>27</sup> Unifikimi i programeve të studimeve të së njëjtës fushë dhe nivel arsimor, është në process e sipër dhe nuk ka përfunduar akoma.</p>
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<p>Nga logimi në faqen zyrtare të UE-së si dhe nga shqyrtimi i evidencave të paraqitura, konstatojmë se kodifikimi i lëndëve të programit BMAP në planin mësimor është realizuar dhe secila lëndë ka kodin përkatës sipas fushës së studimit.<sup>28</sup></p>
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë	<p>Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor nuk ofrohet si program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë.</p>

<sup>25</sup> Plani mësimor i programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.2.

<sup>26</sup> Rregullore e studimeve UNIEL, neni 9, neni 56, 57, Evidenca 1.2; Rregullore e programit të studimit BMAP, Neni 12,13), Evidenca 1.8.

<sup>27</sup> Planet mësimore MBAP viti 2016, viti 2019, Evidenca 1.8.4.

<sup>28</sup> Linku: <https://uniel.ems.al/school/program/e560f491-0838-4418-9be1-acbd00d0dfb31.aspx>

Kodifikimi i lëndëve në programet e studimit në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Evidenca 1.9.



institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.				
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ deklaroi se programi i studimit BMAP ka si qëllim formimin e mësuesve të APSH me njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në fushat akademike dhe profesionale; është hartuar duke respektuar ndarjen në lëndë e module, pikëzimin sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), ruajtjen e raportit të drejtë të pikë krediteve në tre vitet akademike. Konkludojmë se programi i studimit BMAP organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Deklarojmë se FSHE dhe DMM, përgjegjëse për programin e studimit BMAP, i përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin e strukturën akademike dhe është konform kërkesave të neneve 22, 23, dhe 25 të , të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të UE-së (neni 5, pika 2), sipas së cilës “UE përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi baze dhe njësi të tjera.”</p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi është Fakulteti i Shkencave të Edukimit dhe njësia bazë është Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies.</p> <p>Referuar Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që “njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.”</p> <p>Ky kriter plotësohet krejtësisht sepse DMM referuar viteve akademike: 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023 ka në përbërjen e tij 9 pedagogë efektivë me kohë të plotë, të gjithë me tituj dhe grada shkencore (2 Prof. Dr., 5 Prof. As. Dr., 1 Prof. As dhe 1 Docent).<sup>29</sup></p> <p>Përveç kësaj, njësia bazë DMM plotëson edhe kushtin tjetër që personeli akademik me kohë të plotë mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore, pasi në këtë program studimi angazhohen sipas këtyre viteve gjithsej:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2019-2020 angazhohen 22 PAE dhe 4 PAK;</li> </ul>

<sup>29</sup> Aneks, Tabelat përmbledhëse, Tabela 1 dhe Tabela 4. Evidenca 1.8.13.



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2020-2021 angazhohen 22 PAE dhe 4 PAK;</li> <li>- Për vitin akademik 2021-2022 angazhohen 21 PAE dhe 4 PAK.<sup>30</sup></li> </ul> <p>Gjithashtu, në strukturën e departamentit bën pjesë edhe personeli ndihmës akademik me karakter administrativ.<sup>31</sup></p>								
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	<p>Referuar RVB-së dhe bisedave në institucion, themi se FSHE dhe DMM që janë përgjegjëse për programin BMAP, kanë angazhuar një personel ndihmës akademik /administrativ me karakter mësimor për realizimin e praktikave mësimore e laboratorike.<sup>32</sup></p> <p>Procedurat e punësimit dhe përzgjedhja e stafit ndihmës akademik bëhet konform rregullores përkatëse.<sup>33</sup></p>								
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe bisedave me stafin akademik, rezulton se FSHE/DMM ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit BMAP, i cili ishte përgjegjës për ecurinë e programit dhe të praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.<sup>34</sup></p> <p><i>Rekomandohet plotësimi i Rregullores së FSHE dhe i Rregullores së DMM lidhur me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Programit të Studimit.</i></p>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ shprehet se FSHE dhe DMM, struktura përgjegjëse për programin e studimit BMAP, janë ngritur dhe funksionojnë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015, Vendimin e MASR nr.418, datë 10.5.2017, dhe Statutin e Universitetit të Elbasanit.</i></p> <p><i>Rekomandojmë plotësimin e Rregullores së FSHE-së dhe Rregullores së DMM-së me nenin mbi pozicionin e Koordinatorit të Programit të Studimit.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet përbashëit</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet përbashëit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet përbashëit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Informacionet kryesore rreth Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor” sigurohen përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullores së FSHE-së;</li> <li>- Rregullores së DMM-së</li> <li>- Rregullores së Programit të Studimit;</li> <li>- Websitin zyrtar të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” <a href="https://ëëë.uniel.edu.al/">https://ëëë.uniel.edu.al/</a></li> </ul>

<sup>30</sup> Aneks, Tabelat përmbledhëse, Tabela 6.1; 6.2; 6.3. Evidenca 1.8.13.

<sup>31</sup> Organigrama e FSHE-së. Evidenca 1.8.6.

<sup>32</sup> Idem.

<sup>33</sup> Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik. Evidenca 4.3.

<sup>34</sup> Lista e koordinatoreve të programeve të studimit të DMM. Evidenca 1.8.7.



	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve rregullatore të mësim-përme, deklarojmë se e gjithë puna për organizimin e programeve të studimit mbulohet me informacion të hollësishëm rreth: organizimit në kohë dhe në kredite të Programit të Studimit, mënyrës së pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve, mënyrës së organizimit të studimeve në vite, semestra, lëndë, si edhe praktika profesionale, mënyrës së kontrollit të dijeve, informacione rreth frekuentimit, detyrimeve për kryerjen e praktikës profesionale, dhënien e provimit të formimit apo përgatitjen e temës së diplomës, për pajisjen me diplomë, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani Mësimor i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"<sup>35</sup> është ndërtuar në përputhje me përcaktimet e VKM nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe përcakton lëndët/modulet, praktikat dhe aktivitetet formuese, të ndara në vite akademike dhe semestra. Për çdo lëndë/modul përcaktohet kodi i lëndës/modulit, viti/semestri kur zhvillohet, orët në auditor, orët jashtë auditorit, detyrimet e shlyerjes, si edhe kreditet e përcaktuara sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<sup>36</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve të vitit të parë në UE, bazohet së pari në nenin 74 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", duke u nisur nga "kriteri i notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave".</p> <p>Konfirmojmë që të gjitha informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, përcaktohen qartë tek:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja e FSHE-së (Neni 54, 55, 56, 57).</li> <li>- Rregullorja e Programit të Studimit BMAP (Neni 12,13).<sup>37</sup></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit BMAP<sup>38</sup> është ndërtuar sipas përcaktimeve të detajuara në shtojcën nr.2 të vendimit nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë ". Ky plan mësimor përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara,</p> <p>Gjithashtu plani mësimor i programit të studimit BMAP përmban të dhëna për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje të plotë me formatin e miratuar nga UE në përputhje me shtojcën nr.2 të VKM-së së sipërcituar.</p>

<sup>35</sup> Plani Mësimor i Programit të Studimit BMAP. Evidenca 1.8.2.

<sup>36</sup> Rregullore e studimeve BMAP, neni 14, 15, 16. Evidenca 1.8; Plani mësimor i programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.2.

<sup>37</sup> Rregullore e FSHE, neni 54 - 57. Evidenca 1.2; Rregullore e studimeve BMAP, Neni 12 -13. Evidenca 1.8; Aplikime për transferim, ekuivalentim dhe program të dytë të studimeve në BMAP. Evidenca 1.8.9.

<sup>38</sup> Plani mësimor i programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.2.



<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Referuar RVB-së dhe bisedave të zhvilluara në institucion me anëtarët e DMM-së, konstatojmë që përmbajtja e programeve të studimit BMAP përmirësohet dhe përditësohet vazhdimisht me risi dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet e bëra. Ndryshimet më të mëdha në kurrikulën e këtij program studimi janë bërë në vitin 2016 me hyrjen në fuqi të Ligji Nr. 80/2015, për arsimin e lartë për organizimin e programeve të studimit.<sup>39</sup></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se përmbajtja e programit të studimit BMAP organizohet sipas planit mësimor, në të cilin përcaktohet ndarja e lëndëve në semestra, ngarkesa mësimore e lëndëve/moduleve, orët brenda dhe jashtë auditorit, etj., dhe të gjitha procedurat për pranimin, transferimin dhe mbarimin e studimeve përcaktohen në dokumentet rregullatore të FSHE-së dhe DMM-së. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.4</b>  <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Shpërndarja e orëve të lëndëve dhe të praktikave mësimore në leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë. Shpërndarja përgjithësisht është bazuar sipas përcaktimeve të VKM nr.41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar”.  Raporti i orëve leksione/seminare, bazohet në natyrën e lëndës (nëse lëndët janë me natyrë teorike apo praktike), ndërsa sa i përket zhvillimit të lëndëve me zgjedhje, ato koordinohen në varësi të numrit të studentëve që i ndjekin.  Në përfundim të studimeve ky program u mundëson studentëve të punësohen si punonjës arsimor në institucione publike dhe jo publike arsimore.  Konfirmojmë që shpërndarja e lëndëve dhe praktikave përgjatë tre viteve u mundëson studentëve të BMAP thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme. Ata mund të ndjekin studimet në Masterin Profesional Drejtim dhe Administrim Arsimi, program që ofrohet po nga Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies.<sup>40</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave</p>	<p>Sic e kemi cituar më herët në këtë dokument, tek Standardi II.I, kriteri 3, programi i studimit BMAP në Planin mësimor 2022-2025,<sup>41</sup> siguronte ndarjen e lëndëve mësimore sipas këtij raporti:  – lëndë bazë ose të përgjithshme, kategoria A (27 kredite ose 15 %).</p>

<sup>39</sup> Ligji Nr. 80/2015, neni 72, 75; Planet mësimore MBAP viti 2016, viti 2019. Evidenca 1.8.4

<sup>40</sup> Informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar në degën Master Profesional Drejtim dhe Administrim Arsimi, për 5 vitet e fundit. Evidenca 1.8.10.

<sup>41</sup> Plani mësimor i programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.2.



<p>formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- lëndë karakterizuese, kategoria B (95 kredite ose 52.77%).</li> <li>- lëndë ndërdisiplinore, kategoria C (25 kredite ose 13.88%).</li> <li>- lëndë plotësuese, kategoria D (20 kredite ose 11.11%).</li> <li>- detyrime përmbyllëse, kategoria E (6 kredite ose 3.33%). Referuar analizës së mësipërme të përcaktimit të raporteve ndërmjet lëndëve, vërehet se lëndët bazë të studimit (kategoria A), zhvillohen në vit të parë dhe të dytë duke zënë 15% të totalit të krediteve të këtij program studimi dhe duke respektuar kështu raportet (15% - 20%) e përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori.</li> </ul> <p>Po sipas Shtojcës nr.1 (Tabela 1) të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", përcaktohet se "Përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve "Bachelor". U konstatua se ky kusht plotësohej në masën 67.77%.</p> <p>Lëndët ndërdisiplinore (kategoria C) zinin 13.88% të totalit të krediteve, duke qënë brenda fashës prej 12% - 15% të krediteve të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori për studimet Bachelor.</p> <p>Të njëjtën gjë mund të themi edhe përsa i përket lëndëve plotësuese (kategoria D) dhe detyrimeve përmbyllëse (kategoria E). Lëndët plotësuese zinin 11.11% të numrit të përgjithshëm të krediteve duke respektuar raportin prej 10% - 15% kredite të përcaktuara në VKM, Nr. 41/2018 për këtë kategori, ndërsa detyrimet përmbyllëse zinin 3.33% që ishin brenda fashës së përcaktuar 3% - 5% nga VKM e mësipërme.</p> <p>Nga analiza e planit mësimor vumë re që shpërndarja e lëndëve në semestra dhe vite ndiqte parimin e kalimit gradual të studentëve nga koncepte themelore në koncepte dhe aplikime të avancuara të praktikës profesionale dhe të kërkimit shkencor, duke kaluar nga lëndët bazë-hyrëse, si Hyrje dhe Psikologji zhvillimi (Viti I), në lëndë më të avancuara, si Psikologji Edukimi (Viti II), Edukim Gjithëpërfshirës dhe Pedagogji e edukimit familjar (Viti III). Një shpërndarje e tillë u mundëson studentëve që të përvetësojnë në mënyrë organike objektivat formuese të programit të studimit, duke i kthyer ato në rezultate të të nxënit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në planin mësimor 2022-2025 të programit të studimit të marrë në vlerësim, pasqyrohen lëndët të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese, si në vite e semestra, duke përcaktuar për secilën pikë kreditet përkatëse.</p> <p>Raporti teori-praktikë në programin e studimit BMAP rezultoi në masën 88.89% me 11.11%. Shumë pozitive vlerësojmë rolin që ky departament i ka dhënë zhvillimit të Praktikës profesionale. Praktika profesionale shtrihet në të tre vitet e studimit (viti I + viti II + viti III) me një ngarkesë totale prej 20 pikë kreditesh (430 orë) ose 11.11 % të 180 krediteve të përgjithshme.</p> <p>Veprimtaria mësimore e BMAP realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, laboratorëve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, posterave, praktikës.<sup>42</sup></p>

<sup>42</sup> Rregullore e programit të studimit BMAP, Neni 17. 1. Evidenca 1.8.



	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të UE-së, rezulton se struktura e Programit të Studimit BMAP, organizimi i lëndëve dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, dhe raporti teori/praktikë është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, që është VKM nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Shtojca nr.1, Tabela nr.1, i ndryshuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i Studimit BMAP është i organizuar në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur arritjen e rezultateve të të nxënit, me qëllim përgatitjen e studentëve për t’u punësuar sipas profilit të programit. Nëse shikohet struktura e syllabuseve lëndore, vihet re se me kalimin nga viti në vit, kalohet nga aspektet teorike, në aspekte teorike-praktike dhe në fund drejt praktikës dhe aftësimin profesional të studentëve.</p> <p>Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një modul lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit.</p> <p>Mund të thuhet se syllabuset e lëndëve janë ndërtuar në një mënyrë të tillë që mundësojnë transferimin apo mobilitetin i studentëve sipas një procesi të arsyeshëm. Sipas dokumenteve të dorëzuara, organizimi i programit të studimit BMAP në lëndë/module, praktika formuese, etj., ka bërë të mundur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- atashimin e vazhdueshëm në këtë program të studentëve nga IAL të tjera publike dhe jopublike si dhe të studentëve ndërkombëtar (Një studente e Universitetit të Bolonjës u atashua për të zhvilluar praktikën profesionale në programin e studimit BMAP);</li> <li>- zgjedhjen e këtij programi si degë të dytë studimi;</li> <li>- lehtësimin e transferimit të studimeve në IAL-të e tjera.</li> <li>- punësimin në institucionet publike/jo publike në përfundim të studimeve.<sup>43</sup></li> </ul> <p>Referuar të dhënave për punësim, për vitin 2020-2021 janë punësuar 4 studentë që janë diplomuar po këtë vit në programin e studimit BMAP nga ZVAP Pogradec.<sup>44</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Syllabuseve të lëndëve të programit të studimit BMAP,<sup>45</sup> vumë re që literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar sigurohej në gjuhën shqipe dhe kjo siguronte lehtësi për studentët. Konstatuam se disa lëndë/module kishin bërë përditësim të literaturës së detyrueshme dhe asaj të rekomanduar me botime të viteve të fundit. Por pjesa tjetër e lëndëve dhe moduleve kishin kryesisht literaturë jo të 5 viteve të fundit.</p> <p><b>Rekomandohet përditësimi i literaturës së detyruar, i programeve të disa lëndëve/moduleve të programit të studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”, me literaturë të 5 viteve të fundit.</b></p>

<sup>43</sup> Aplikime për transferim, ekuivalentim dhe program të dytë të studimeve në BMAP Evidenca 1.8.9; Plani mësimor BMAP. Evidenca 1.8.2; Evidenca 1.8.5 Marrëveshja e Bolonjës.

<sup>44</sup> Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021. Evidenca 5.6.

<sup>45</sup> Syllabuset e Programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.3.



<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të suajara.</p>	<p>Misioni i programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", sipas Rregullores së Programit të Studimit<sup>46</sup>, parashikon se ky program ka si qëllim "T'u ofroje profesionistëve të ardhshëm koncepte dhe aftësi të planifikimit, drejtimit, organizimit, zbatimit dhe monitorimit të veprimtarive mesimore; t'u ofrojë studentëve një formim intelektual, duke përfshirë të gjitha llojet e aspekteve praktike dhe teorike të fushës së mësimdhënies."</p> <p>Këto aftësi dhe kompetenca garantoohen përmes zhvillimit dhe përvetësimit të lëndëve të tilla si: Gjuhë shqipe; Letërsi për fëmijë; Matematikë elementare, Njohuri mbi natyrën; Psikologji zhvillimi, Psikologji edukimi; Edukim Qytetar; Etikë profesionale e mësuesit; Didaktikë; Didaktikë e edukimit fizik; Modelim vizual i hapësirës; Të mësuarit nëpërmjet lojës; Kukullat, drama, media; Teknologji informatike, etj.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit BMAP i ofruar nga Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", i korrespondon nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Sipas Shtojcës 1 të kësaj kornize, përfundimi me sukses i këtij programi u mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Master i Shkencave</li> <li>- Master Profesional</li> </ul> <p>Studentët e BMAP mund të vazhdojnë studimet duke ndjekur Masterin Profesional Drejtimit dhe Administrim Arsimit, që ofrohet po nga DMM-ja. Përfundimi me sukses i Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, u mundëson punësimin drejt profesionit të mësuesisë në arsimin parashkollor.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se programi BMAP i përket nivelit 6 sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe është konform përcaktimeve të VKM nr.41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, të ndryshuar". Ky kriter përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi II.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh</p>	<p>Sipas bisedave të zhvilluara me anëtarët e DMM-së dhe sipas RVB-së, themi se ky department konsultohet dhe merr parasysh propozimet që vijnë nga aktorë jashtë institucionit. Po ashtu, marrëveshjet e bëra me Zyrën Vendore Arsimore Parauniversitare, Elbasan dhe Bashkinë e Elbasanit, tregojnë për lidhjen e FSHE-së dhe DMM-së me institucionet partnere,</p>

<sup>46</sup> Rregullore e Programit të Studimit BMAP, Neni 6. Evidenca 1.8.



propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	sigurimin e informacionit mbi punësimin e të diplomuarve të saj dhe komunikimin për përmirësimin e programit të studimit. Monitorimi i punësimit të diplomuarve të tij, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar, i shërbente departamentit edhe për të parë se sa përputhet formimi që ata marrin në fakultet me kërkesat e tregut të punës. <sup>47</sup>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Siç e cituam më sipër, FSHE dhe DMM ka krijuar një database me të dhëna mbi studentët e diplomuar dhe mban kontakte të vazhdueshme me to me qëllim shkëmbimin e mendimeve lidhur me përmirësimin e programit të studimit. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga FSHE dhe DMM, dhe bisedave të qëllimta të bëra në institucion me studentët e këtij program studimi, evidentuam se Universiteti i Elbasanit nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët angazhoheshin në Senatin Akademik UE <sup>48</sup> dhe organizoheshin tek Këshilli Studentor. <sup>49</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Referuar raportit të RVB-së, implementimi në Asimin Parashkollor i Kurrikulës bazuar në kompetenca, pasqyrohet në syllabuset lëndorë të programit BMAP. Trajnimet dhe literatura e ofruar nga Organizata jofitimprurëse Save the Children, kanë ndikuar në përmirësimin dhe përditësimin e mësimdhënies në këtë program studimi. Hapi i radhës që do u ndërmerre nga DMM-ja, ishte pasqyrimi i këtyre zhvillimeve edhe në planin mësimor. <sup>50</sup>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se Universiteti i Elbasanit nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët ishin të organizuar në Këshillin Studentor dhe merrnin pjesë në Senatin Akademik të UE-së. DMM kishte krijuar një database mbi studentët e diplomuar dhe mbante kontakte për marrjen e mendimit të tyre lidhur me përditësimin dhe përmirësimin kurrikulave të programit të studimit BMAP. Ky kriter përmbushet kryesisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<sup>47</sup> Punësimi i studentëve parashkollor. Evidenca 1.8.11.

<sup>48</sup> Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL. Evidenca 2.2.

<sup>49</sup> Rregullore e Këshillit Studentor. Evidenca 2.3.

<sup>50</sup> Syllabuset e programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.3.



### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në Rregulloren e studimeve në FSHE<sup>51</sup> në nenin 20, theksohen se format e mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- leksionet</li> <li>- seminarët</li> <li>- seancat e praktikave profesionale</li> <li>- lëndët individuale artistike</li> <li>- ushtrimet</li> <li>- laboratorët</li> <li>- studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash, projektesh</li> <li>- përgatitje për provime</li> <li>- përgatitje e tezës së diplomës</li> <li>- veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo pranë subjekteve publike ose private.</li> </ul> <p>Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve, që ka secila disiplinë.<sup>52</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në RVB, personeli akademik respekton dhe u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve. Në rastet kur studentët paraqesin nevoja të veçanta, personeli akademik ofron forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit (përfshirë këtu përcjelljen përmes platformës Teams të materialeve të ndryshme të studimit, leksione, prezantime, detyra etj.)<sup>53</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Përmes bashkëpunimeve të arritura të UE-së me institucione të tjera partnere, konfirmojmë që Universiteti i Elbasanit mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personeleve akademike dhe ndihmës akademike pranë universiteteve partnere, me qëllim përmirësimin e kompetencave të tyre.<sup>54</sup></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive</p>	<p>Bazuar në jetëshkrimet e stafit akademik efektiv, rezulton se personeli akademik në DMM përbëhet nga pedagogë me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe me kualifikime të spikatura në këtë drejtim.<sup>55</sup></p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënien është i specializuar në lëndët/modulet që mbulon dhe kompetent në shpjegimin e njohurive e</p>

<sup>51</sup> Rregullore e studimeve në Fakultetin e Shkencave të Edukimit. Evidenca 1.7.

<sup>52</sup> Aneks Tabelat përmbledhëse-Tabela 9 Plani mësimor i programit të studimit; Tabela 10 Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10. Evidenca 1.8.13.

<sup>53</sup> Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams. Evidenca 6.1.

<sup>54</sup> Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+; Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve. Evidenca 3.1.

<sup>55</sup> Aneks Tabelat përmbledhëse, Tabela 6: Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit. Evidenca 1.8.13.



<p>dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, të cilat nxitin ndërveprimin, të menduarit kritik dhe krijues te studentët. Në ndarjen e ngarkesës mësimore bëhet kujdes që disiplinat të përputhen me fushën e ekspertizës së personelit akademik përkatës.<sup>56</sup> Për lehtësimin e komunikimit të studentëve me strukturat përkatëse të FSHE-së, drejtuesi i DMM kishte emëruar koordinatoren e programit të studimit BMAP.<sup>57</sup></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimin dhe përmirësimin e programit të studimit BMAP realizohej nga Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies përmes marrjes së mendimit të studentëve me anë të anketimit. Sipas raportit të RVB-së dhe bisedave të qëllimita gjatë vizitës në institucion, në përfundim të lëndës/modulit personeli akademik realizonte me studentët pyetësorë për vlerësim.<sup>58</sup> Nuk kishte një raport të tillë të analizës së rezultatetve nga pyetësorët me studentët. Do të ishte mirë që raporti i analizës së pyetësorit të përfshihej në dokumentet e dorëzuara nga FSHE dhe DMM.  <i>Rekomandojmë që raporti i analizës së pyetësorëve të përfshihet në dokumentet e dorëzuara nga DMM dhe të botohet në faqen zyrtare të Universitetit të Elbasanit ku mund të aksesohet me lehtësi si nga studentët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>UE ka në përbërje të saj strukturë ndihmës akademike me funksion koordinimin institucional, kërkimit shkencor dhe projektet. Referuar të dhënave mbi aktivitetet e realizuar në vitin akademik 2021-2022, kjo strukturë ka organizuar aktivitete të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personleve akademike për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.<sup>59</sup> Në këtë institucion është ngritur dhe funksionon Qendra e të mësuarit Gjatë Gjithë Jetës e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET, e cila ndihmon stafin në rritjen e tij profesionale dhe përdorimin e metodave inovative.<sup>60</sup> Konfirmojmë që anëtarë të stafit akademik të DMM-së janë prej vitesh trajnerë të moduleve të trajnimit të mësuesve të arsimit parauniversitar.<sup>61</sup> Po ashtu, në UE funksionon zyra e Buletinit Shkencor, e cila është përgjegjëse për publikimin periodik të revistës.<sup>62</sup></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se UE, FSHE dhe DMM kontribuojnë me anë të metodave dhe praktikave të ndjekura për një mësimdhënie cilësore që i shërben aftësitë profesional dhe shkencor të studentëve të programit të studimit BMAP. Rekomandojmë që raporti i analizës së pyetësorëve të përfshihet</i></p>

<sup>56</sup> Aneks Tabelat përmbledhëse-Tabela 2: DMM përgjegjës për programin e studimit BAMP; Tabela 7: Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre. Evidenca 1.8.13; Statuti i UE, neni 22. Evidenca 1.1.

<sup>57</sup> Lista e koordinatorëve të programit të studimit. Evidenca 1.8.7.

<sup>58</sup> Pyetësor me studentët për vlerësim të lëndës. Evidenca 1.8.14.

<sup>59</sup> Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022. Evidenca 3.3.

<sup>60</sup> Marrëveshja për krijimin e qendrës. Evidenca 3.5.

<sup>61</sup> Modulet e trajnimit në FSHE. Evidenca 1.8.18.

<sup>62</sup> Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022. Evidenca 3.3.



	në dokumentet e dorëzuara nga DMM dhe të botohet në faqen zyrtare të Universitetit të Elbasanit.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Ne Rregulloren e programit të studimit BMAP në nenin 19 të saj përcaktohen të gjitha kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve në provimet lëndore, si: vlerësimi në provimet me shkrim, me zë apo në provimet e kombinuara; mënyra e ruajtjes së anonimatit të studentit përmes sekretimit të fletëve provimit; korrigjimi, ballafaqimi me studentët dhe njohja me rezultatet e provimit, etj. Pas këtyre procedurave, rezultatet e provimeve bëhen publike. Po ashtu edhe në nenin 39-47 të Rregullores së FSHE-së paraqitet në mënyrë shumë të detajuar mënyrat e vlerësimit përfundimtar të nxënësve në një lëndë apo modul deri në kriteret e përmirësimit të notës. Vlerësimiet e studentëve bëhen publike kur pasqyrohen në sistemin EMS. <sup>63</sup> Sipas dokumentit të RVB-së, UNIEL zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSORE të financuar nga AADF. <sup>64</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Neni 19, Pika 1 e Rregullores së programit të studimit BMAP, thekson se <i>“Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mesimor, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve.”</i> Po ashtu, referuar RVB-së dhe bisedave në institucion, deklarojmë që çdo titullar lënde, në ditën e parë të zhvillimit të mësimin me studentë, prezantojnë metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Anëtarët e stafit akademik ngarkojnë në sistem temat që do të zhvillohen për të gjitha javët. Ky informacion aksesohet nga studentët gjatë gjithë vitit akademik. <sup>65</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Ky kriter mbështetet dhe orientohet nga të gjithë dokumentet rregullatore të institucionit <sup>66</sup> , të cilat përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve. Në programin e lëndës jepen detyrimet e studentit dhe shprehen modalitetet e vlerësimit të ndarë në dy pjesë: vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përfundimtar (provim). Secili titullar lëndë/moduli i përcakton qartë llojin e vlerësimeve dhe ato janë të shumëllojshme: me shkrim, me gojë, me detyra kursi, projekte, prezantime, etj. <sup>67</sup>

<sup>63</sup> Neni 11, pika b. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit në edukim në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” [https://www.uniel.edu.al/images/universiteti/statuti-dhe-rregullore/Rregullore\\_organizimi\\_funksionimi\\_sistemit\\_menaxhimit\\_educim\\_UE.pdf](https://www.uniel.edu.al/images/universiteti/statuti-dhe-rregullore/Rregullore_organizimi_funksionimi_sistemit_menaxhimit_educim_UE.pdf)

<sup>64</sup> Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE. Evidenca 3.6.

<sup>65</sup> Rregullore e studimeve UNIEL, neni 27. Evidenca 1.2.

<sup>66</sup> Rregullorja e studimeve në UE. Evidenca 1.2; Rregullorja e organizimit të studimeve në FSHE; Rregullorja e programit BMAP (Neni 19).

<sup>67</sup> Aneks Tabelat përmbledhëse-Tabela 14: Modeli i syllabuseve sipas VKM 41/2018). Evidenca 1.8.13.



<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Pririmi të besojmë se mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve lidhur me përmirësimet e metodave të mësimdhënies dhe materialeve të përdorura në lëndë/module, merreshin përmes aplikimit të pyetësorëve me studentë. Stafi akademik i administronte këto pyetësorë dhe sugjerimet e studentëve merreshin parasysht.<sup>68</sup></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Bazuar në Syllabuset e lëndëve të programit të studimit BMAP<sup>69</sup> deklarojmë që liria akademike e pedagogëve në konceptimin e lëndëve të tyre dhe larmishmëria e metodave pedagogjike që secili prej tyre pasqyrojnë në syllabueset e lëndëve sipas rezultateve të pritshme të të nxënit, inkurajonte studentët për punë individuale, në grup apo në projekte. Referuar bisedave të zhvilluara me pedagogë efektivë dhe të jashtëm të DMM-së, themi se stafi akademik përdorte një llojshmëri metodash pedagogjike: në leksione përdornin zakonisht metodat ndërvepruese me studentët, ndërsa në seminare përdornin shumë mikro-mësimdhënien, situatën problemore, punë në dyshe, në grup, etj.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se procesi i vlerësimit dhe i testimit të dijeve mbështetet plotësisht në aktet rregullatore të Universitetit të Elbasanit. Zhvillimi i procesit mësimor realizohej përmes aplikimit të metodave të larmishme të mësimdhënies, të cilat ishin pjesë e vlerësimit të studentëve në përfundim të çdo lënde apo moduli.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi III.3</b> Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.</p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas Rregullores së FSHE-së, Neni 35, pika 4, shkruhet se “Vlerësimi përfundimtar i studentit është rezultat i tre përbërësve: vlerësimi i vazhduar, vlerësimi i ndërmjetëm gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e lëndës/modulit dhe vlerësimi i provimit.”</p> <p>Referuar programeve lëndore (syllabuset) të cilat zhvillohen në programin e studimit Bachelor në Arsimin Parashkollor, kategorisë “Forma e kontrollit të dijës dhe frekuentimi”, vërehet se i gjithë procesi përfshin kontrollin e vazhdueshëm të njohurive, kontrollin e ndërmjetëm dhe kontrollin përfundimtar, ku studentit vlerësohet sipas këtyre komponentëve: frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive, detyra e kursit, testi i pjesshëm dhe provimi përfundimtar. Gjatë javëve të zhvillimit të programeve lëndore, studentët i nënshtroheshin vlerësimit të detyrave të kursit, provimeve të</p>

<sup>68</sup> Pyetësor me studentët për vlerësim të lëndës. Evidenca 1.8.14.

<sup>69</sup> Syllabuset e programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.3.



	<p>ndërmjetme/kolokiumeve apo orëve laboratorike. Secili pedagog në vërësi të programit të lëndës, përcaktonte edhe përqindjen e formave të kontrollit në kontrollin e përgjithshëm të studentëve.<sup>70</sup></p> <p>Vlerësimi i komunikohet studentit në orën e fundit të mësimit sipas përcaktimeve të bëra në planin mësimor të programit të studimit, në rregulloren e organizimit të studimit si dhe përcaktimeve përkatëse në syllabus-in e lëndës të bëra nga titullari i lëndës/modulit.<sup>71</sup></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në deklaratimet e RVB-së, Universiteti i Elbasanit zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSORE të financuar nga AADF.<sup>72</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar bisedave në institucion, programeve lëndore (Syllabuseve) dhe dy rregulloreve: Rregullores së studimeve të UE-së dhe Rregullores së FSHE-së, konstatoam se për lëndët/modulet të cilat në planin mësimor të programit të studimit nuk përcaktoheshin me provim, shlyerja dhe vlerësimi i tyre realizohej me anë të kontrollit të vazhdueshëm dhe të ndërmjetëm dhe vlerësimi përfundimtar i studentit i komunikohet në orën e fundit të mësimit. Kjo procedurë kryhej sipas përcaktimeve të bëra në planin mësimor të programit të studimit, në Rregulloren e organizimit të studimit në FSHE si dhe përcaktimeve përkatëse në syllabus-in e lëndës të bëra nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p>Sipas Nenit 33, pika 6, të Rregullores së studimit në FSHE, <i>“Vlerësimi i vazhduar gjatë gjithë vitit për lëndët/modulet e cilësuarat provim në planin mësimor përfaqson 20% - 40% të vlerësimit përfundimtar.</i></p> <p>Në shumicën e programeve lëndore, ky raport i përcaktuar në Rregulloret e studimit zakonisht respektohej. Por në disa programe lëndore, raporti vlerësimi i vazhdueshëm/vlerësim përfundimtar, nuk respektohej. Përmendim këtu Syllabuset e lëndët e mëposhtme të vitit të parë Ba Arsim Parashkollor, ku tek lënda Hyrje dhe Psikologji Zhvillimi, provimi përfundimtar zinte 45% të vlerësimit të përgjithshëm të lëndës; Bota sociale e fëmijës (40%), Letërsi për fëmijë (50%), Filozofi dhe Sociologji edukimi (50%). Apo lëndët e vitit të dytë, si: Psikologji edukimi (40%); Didaktikë e gjuhës dhe e leximit (50%).</p> <p><i><b>Rekomandojmë që, në disa syllabuse lëndore, të rishikohet raporti i vlerësimit të provimit përfundimtar të studentëve me atë të vlerësimit të vazhduar dhe ky raport të jetë sipas përcaktimeve të bëra në Rregullores së studimit në FSHE (Neni 33, pika 6).</b></i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve</p>	<p>Sipas bisedave të qëllimita të kryera me pedagogët që jepnin mësim në programin e studimit Ba Arsim Parashkollor, vlerësimi i njohurive të studentit bëhej i shoqëruar me komentet përkatëse dhe aty ku ishte e nevojshme studentëve u jepeshin këshilla në lidhje me arritjen e një performance më të mirë akademike. Pas korrigjimit të provimeve, ditën e dhënies së rezultateve, lihej një seancë ballafaqimi i komisionit të provimit me studentët në lidhje me</p>

<sup>70</sup> Syllabueset e programit të studimit BMAP. Evidenca 1.8.3

<sup>71</sup> Rregullore e studimeve UNIEL, neni 27, neni 40, Evidenca 1.2; Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE, neni 24, 37, 38, 39, 40, Evidenca 1.7; Aneks Tabelat përmbledhëse-Tabela 14 Modeli i syllabuseve sipas VKM 41/2018, Evidenca 1.8.13.

<sup>72</sup> Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE. Evidenca 3.6.



për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	vlerësimin e bërë. E gjithë procedura realizohej konform Rregullores së FSHE-së. <sup>73</sup>
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Baza ligjore e cila mbështeste zbatimin me rigorozitet të këtij kriteri, ishte Rregullorja e studimeve të FSHE-së dhe Kodi i Etikës në UE.</p> <p>Në Rregulloren e FSHE-së, Neni 41, pika 2/e, shkruhet se “<i>Studenti nuk fiton kreditet e një lënde: kur shkel elementët e Kodit të Etikës, që prekin aktivitetin studentor, sidomos përsa i përket detyrimit të studentëve për të mos kopjuar në provime, në punën e dikujt tjetër, për të mos fabrikuar të dhëna dhe respektuar dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë dhe personelit akademik dhe atj mbështetës.</i>”</p> <p>Ndërsa në Kodin e Etikës në UE, Neni 15.4, pika f, shkruhet: “<i>Në UE studentët kanë detyrimin të mos kopjojnë në provime, të mos mashtrojnë gjatë procesit mësimor, të mos kopjojnë punën kërkimore-shkencore të dikujt tjetër.</i>”</p> <p>Për të shmangur plagjiaturën apo kopjimin në provime dhe detyra, Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies dhe stafi akademik i tij, zbatonte procedurat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- monitorimin e procesit të provimeve me anë të Komisionit të provimit të lëndës;</li> <li>- zbatimin e rregullave të përcaktuara në Rregulloren e FSHE-së dhe në Kodin e Etikës në UE.</li> </ul>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Sipas bisedave me anëtarët e DMM-së, priremi të besojmë se vlerësimi i studentëve bazohej mbi meritë, sipas nivelit të përvetësimit të dijeve dhe aftësive të tyre profesionale.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve u jepeshin studentëve sipas afatit të caktuar në Rregulloren e studimit të FSHE-së, ku në Nenin 39, pikën 1 të saj, shkruhet se “<i>Vlerësimet e studentëve pasqyrohen brenda 6 ditëve në Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të UE-së.</i>”</p>
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Garancia e të drejtave të studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit sigurohej nga rregullat që përfshiheshin në Rregulloren e studimit të FSHE-së. Sipas kësaj Rregulloreje, në Nenin 40, pika 2, shkruhet se “<i>Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim nrenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të njësisë bazë me një ankesë me shkrim.</i>”</p>
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>Procedura e ndjekur për çdo ankimim apo kërkesë të studentit në lidhje me rezultatin e provimit, ishte transparente sepse çdo gjë që lidhej me të, parashikohej shumë qartë në Nenin 40, pika 2, në të cilin “<i>Drejtuesi i njësisë bazë vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe ngarkon komisionin me aktin përkatës, që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqimin me studentin. Ky vendim është i formës së prerë dhe depozitohet në njësinë bazë dhe sekretarinë mësimore. Komisioni merr vendim për rivlerësim. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem.</i>”<sup>74</sup></p>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se DMM dhe FSHE kryen vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve të programit të studimit BMAP sipas të gjithë parashikimeve të vendosura në Rregulloren e FSHE-së, në Kodin e Etikës në UE, në programet lëndore dhe duke u bazuar në meritokraci.</i>

<sup>73</sup> Rregullore e FSHE-së, Neni 41, 42. Evidenca 1.7.

<sup>74</sup> Rregullore e studimit të FSHE-së. Evidenca 1.7.



	<b>Rekomandojmë që, në disa syllabuse lëndore, të rishikohet raporti i vlerësimit të provimit përfundimtar të studentëve me atë të vlerësimit të vazhduar dhe ky raport të jetë sipas përcaktimeve të bëra në Rregullores së studimit në FSHE.</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Nga shqyrtimi i programeve lëndore dhe planit mësimor, konstatoam se përmes tyre studentët e BMAP marrin njohuri të thelluara shkencore dhe profesionale lidhur me profesionin e mësuesit të Arsimit parashkollor që do të ushtrojnë. Format e larmishme të punës së përshkruar në Syllabuset lëndore, si: diskutime, studim rastesh, detyra individuale dhe në grup, zhvillojnë aftësitë e përgjithshme dhe të veçanta të studentëve. Ashtu siç e kemi shqyrtuar tek standardi II.4, kriteri 3, hapësira e madhe e caktuar për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve në ambientet e institucioneve arsimore parashkollore, tregon për zhvillimin e aftësive profesionale dhe përdorimin e kompetencave të fituara teorikisht në praktikë. Praktika profesionale shtrihet në të tre vitet e studimit (viti I + viti II + viti III) me një ngarkesë totale prej 20 pikë kreditesh (430 orë) ose 11.1 % të 180 krediteve të përgjithshme.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Përveç lëndëve bazë metodologjike dhe lëndëve karakterizuese për përgatitjen për disiplinën, programi i studimit BMAP përmban edhe lëndë integruese/ndërdisciplinore dhe lëndë plotësuese. Përmes këtyre të fundit, studentët kanë mundësinë të zhvillojnë aftësitë e tyre në teknologji, në shkencat humane, komunikim dhe ndërveprim. Lëndë të tilla si: Teknologji informative, Histori e arsimit shqiptar, Gjuhë e huaj, Koreografi, Komunikim pedagogjik, Edukim koral dhe Mësim instrumenti, përfshiheshin në planin mësimor të BMAP-së dhe synonin zhvillimin e kompetencave të mësipërme të studentëve. <sup>75</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë vizitës në institucion, na u konfirmua se Syllabuset lëndore ishin pjesë e analizës vjetore që secili nga pedagogët e realizonte për ta përditësuar atë dhe për të ardhur më afër nevojave të studentëve dhe zhvillimeve të fundit. Kjo gjë kërkohej nga përgjegjësi i DMM-së dhe rishikimi bëhej nga pedagogu përgjegjës. Në fund të çdo viti akademik, në mbledhjen e DMM-së shqyrtoheshin Syllabuset dhe sugjeroheshin përmirësimet e duhura. Kjo veprimtari pasqyrohej edhe në Analizën vjetore të punës në DMM, në të cilën dilet dhe me rekomandimet përkatëse. Një nga rekomandimet e bëra në Analizën e punës vjetore, ishte: <i>Në hartimin e programeve të reja mësimore (syllabuse) të behet përditësimi me literaturën shkencore e bashkohore dhe</i>

<sup>75</sup> Aneks Tabela përmbledhëse, Tabela 9. Plani mësimor në Programin e studimit Mësuesi në Arsimin Parashkollor. Evidenca 1.8.13.



	<i>të bëhet kjo edhe duke përfshirë punën e studentit në bibliotekë, në shfrytëzimin e fondit të saj.<sup>76</sup></i>			
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikë profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Shqyrtimi i Planit mësimor <sup>77</sup> dhe i Syllabuseve lëndore, na lejojnë të vërejmë se shumë lëndë përveç zhvillimit të tyre në auditorë, përmbanin edhe orë laboratorike. Orët laboratorike dhe pesha prej 11 % e praktikës profesionale në raport me të gjithë lëndët shkencore e profesionale, tregonte se DMM-ja ishte shumë serioz në zhvillimin e kompetencave të plota të studentëve. Nga bisedat e zhvilluara me studentët e programit të studimit BMAP rezultoi se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, përdorte forma të larmishme të mësimdhënies. Ata na konfirmuan se pothuajse në çdo lëndë, përveç aktivizimeve me gojë, ata paraqisnin punime, detyra kursi, studime rasti, etj. Metodologjia e punës ishte e larmishme, ku ata ndiheshin të lirë të zgjidhnin nëse punimin e tyre do ta zhvillonin individualisht apo në dyshe, në grup, etj. Zhvillimi i praktikave profesionale të studentëve në institucionet arsimore parashkollore, mundësohej nga marrëveshjet e bëra me Bashkinë e qytetit të Elbasanit. <sup>78</sup>			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Bazuar në raportin e RVB-së, mund të themi se, DMM dhe FSHE ka zhvilluar orë mësimore të hapura. Në kuadër të zhvillimit të projektit LECU (në vitin 2018), ishin mbajtur orë të hapura mësimore, ku synohej ndërthurja e të rejave më të fundit në fushën e mësimdhënies dhe teknologjisë. <sup>79</sup>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se DMM dhe FSHE garanton thellimin e njohurive shkencore dhe profesionale të studentëve të BMAP, zhvillon aftësitë dhe kompetencat e tyre me anë të përdorimit të metodave dhe formave të larmishme të mësimdhënies si gjatë orëve të zhvilluara në auditorë, laboratorë dhe në praktikën profesionale.</i>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Për përcaktimin e gjithë procedurave për zhvillimin e provimit të përgjithshëm apo mbrojtjen e diplomës, UE dhe FSHE kanë hartuar Rregulloren e studimeve

<sup>76</sup> Analiza Vjetore e Departamentit të Metodologjisë së Mësimdhënies, fq. 7. Evidenca 1.8. 1.

<sup>77</sup> Aneks Tabela përmbledhëse, Tabela 11. Evidenca 1.8.13.

<sup>78</sup> Marrëveshja për zhvillimin e praktikës profesionale me Bashkinë. Evidenca 1.13.

<sup>79</sup> Projecti LECU. Evidenca 1.8.15. <https://phzh.ch/en/Services/IPE/Neëslis/2018/lecu-phzh/>



	<p>në FSHE dhe kanë hartuar dhe miratuar edhe formatin e punimit të diplomës, të cilin dhe e ka publikuar.<sup>80</sup></p> <p>Në Nenin 25. 3 të Rregullores së programit të studimit MBAP, nuk përcaktohet pragu i notës mesatare për të bërë punim diplome: <i>“Per te fituar te drejten e hyrjes ne Provimin e formimit/punim diplome studenti duhet te kete marre vleresime pozitive ne te gjitha lendet mesimore dhe ne praktike.”</i></p> <p>Ndërsa në Nenin 58, pika 3 të Rregullores së studimit në FSHE, pragu i notës mesatare është jo më pak se 8 (tetë): <i>“Ka te drejtë te diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, studenti i cili mesataren e ponderuar të dy viteve te para të studimit e kane jo me pak se 8 (tetë).”</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Detyrimet përmbyllëse të studentëve të BMAP janë provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës. Sipas bisedave të zhvilluara me anatarët e DMM-së, na u konfirmua se Programi i provimit përfundimtar i formimit ishte gjithëpërfshirës dhe hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohej nga drejtuesi i departamentit si dhe Dekani i Fakultetit.</p> <p>Në fillim të vitit të fundit të studimeve, departamentet përcaktonin fushat e studimit për punimet e diplomave. Personeli akademik orientonte studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistonte dhe i mbështeste ata në zhvillimin e tyre. Pedagogu udhëheqës i vinte në dispozicion udhëzuesin për hartimin e temës dhe formatin përkatës. Për realizimin e punimit të diplomës ndiqej Manuali i punimit të diplomës.<sup>81</sup></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Të gjitha procedurat e zhvillimit të provimit të përgjithshëm përcaktohen në dokumentet rregullatore të UE-së dhe FSHE-së.<sup>82</sup> Provimi i formimit/punim diplome realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga 3-5 personel akademik të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga departamentet përkatëse dhe miratohen nga dekani. Komisioni i provimit përfundimtar përbëhet nga titullarët e lëndëve të përzgjedhura, të cilët hartojnë tezën e provimit final duke u mbështetur në literaturën dhe njohuritë që studentët kanë marrë gjatë viteve të shkollimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në rastin e përgatitjes së temës së diplomës, personeli akademik orientonte studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistonte dhe i mbështeste ata në zhvillimin e tyre. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatiste programin e punës së studentit bashkë me afatet e përafërta të realizimit të tij, si dhe përcaktonte edhe grafikun e konsultimeve të programuara me studentin.</p> <p>Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikonte, miratonte punimin e kryer nga studentin dhe lejonte mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.<sup>83</sup></p>

<sup>80</sup> Manuali i punimit të diplomës. Evidenca 3.10.

<sup>81</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, nenet 62-63; Evidenca 1.7 Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE, nenet 60-61; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BaMAP, neni 25; Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës.

<sup>82</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 63; Evidenca 1.7 Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE, neni 63; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BMAP, neni 25.

<sup>83</sup> Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës.



<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	E gjithë përgjegjësia e njësisë bazë në lidhje me detyrimet për punimet e diplomës, përcaktohet shumë qartë tek Manuali i punimit të diplomës. Në këtë manual, përshkruhet hollësi përgjegjësitë e institucionit dhe udhëheqësit të diplomës ku parashikohen edhe ndihma në përzgjedhjen dhe zbatimin e metodologjisë së studimit.			
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të formimit/mbrojtje e diplomës studenti vlerësohet me notë (5-nota minimale për të kaluar dhe 10-nota maksimale). Sipas nenit 63, pika 3 dhe 4, në Rregulloren e studimeve në FSHE, shkruhet: <i>“Vlerësimi i punimit të diplomës pasqyrohet në proces verbalin pëckatës dhe Sistemin e menaxhimit të dhenave. Në përfundim të procesit, Kryetari i Komisionit hedh rezultatin e vlerësimit në Sistemin elektronik të menaxhimit të dhenave.</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Po sipas dokumenteve rregullatore të UE-së dhe FSHE-së, në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve. Po ashtu, në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar me kërkesën e tij. Studenti mund të pajiset me programet e lëndëve në varësi të kërkesës së tij, por nuk është pjesë e detyrueshme e dokumentacionit, si diploma dhe suplementi.			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Referuar vizitës së bërë në Sekretarinë mësimore të FSHE-së, na u sigurova nga dy sekretaret e saj se institucioni ruante në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe nëse ky informacion u kërkohej, atëherë u vihej në dispozicion të studentit. Nga kontrolli i regjistrimit themeltar, vumë re që regjistri përbante të gjithë të dhënat e plota lidhur me studentin. Në mbyllje të studimit, studentët kishin të drejtën të tërheqin dokumentacionin personal. <sup>84</sup>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se e gjithë procedura për kryerjen e detyrimeve përmbyllëse të studentit ishte e mbështetur në dokumentet rregullatore të Universitetit të Elbasanit, FSHE-së dhe DMM-së. Studentët asistoheshin dhe mbështeteshin nga stafi akademik për plotësimin e detyrimeve të tyre dhe i gjithë dokumentacioni që ata kishin nevojë u vihej në dispozicion konform këtyre rregulloreve.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<sup>84</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, neni 67.

Evidenca 1.7 Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE, neni 65.



**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Konstatohet se personeli akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit akademik për drejtimin e programit, mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. Stafit akademik i Departamentit që mbulon programin përbëhet nga 9 anëtarë me përvojë të spikatur në fushat e tyre. Gjithashtu, për lëndë specifike Departamenti bashkëpunon me departamente të tjera në FSHE apo pedagogë të brendshëm të fakulteteve të tjera në UE që mbulojnë lëndë specifike <sup>85</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Evidentohet se personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kualifikimet përkatëse dhe konform kriterëve ligjore <sup>86</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Bazuar në evidencën përkatëse rezultojnë se institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit në vijimësi, sespe ky program ka që në vitin akademik 1995-1996 dhe një pjesë e pedagogëve vijnë që në atë periudhë <sup>87</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën,	Evidentohet se institucioni zbaton procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin e stafit, vlerësimin e performancës së tyre sepse bëhen njoftime publike për rekrutime, sipas kriterëve përkatëse për kualifikimet dhe pozicionin e punës, por dhe me anë të shqyrtimit të dosjeve të aplikimit, komisioneve të vlerësimit dhe shpalljes së fituesve <sup>88</sup> .

<sup>85</sup>Evidenca 1.8.13 Aneks Tabelat përmbledhëse-Tabela 6.1, 6.2, 6.3 Cilësia e stafit akademik për programin e studimit; Evidenca 1.8.13 Aneks Tabelat përmbledhëse- Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.

<sup>86</sup> Evidenca 1.8.13 Aneks Tabelat përmbledhëse-Tabela 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.

<sup>87</sup> Evidenca 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022.

<sup>88</sup> Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL; Evidenca 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmëskademik; Evidenca 4.4 Rregullore e rekrutimit të personelit.



<p>modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në mjediset e laboratorëve të fakultetit, si dhe nga takimi me stafin e programit evidentohet se institucioni siguron dhe garanton angazhimin e një personelit të përshtatshëm, ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit<sup>89</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave, por dhe nga takimi me Zyrën e Burimeve njerëzore dhe Përgjegjës in departamentit rezultojnë se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, duke respektuar të dhënat personale<sup>90</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Rezultojnë se institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit me Bashkinë Elbasan<sup>91</sup>, si dhe Bordin Këshillimor të Biznesit (një organizëm që funksiononte për punësimin në të ardhmen të studentëve) dëshmon se studentët informoheheshin për vendet e punës dhe me kërkesat e punëdhënësve<sup>92</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Nga bisedet me studentët rezultojnë se ata kishin bashkëpunime të mira me mësueset e kopshteve ku zhvillojnë praktikën<sup>93</sup> dhe ndjeheshin të mirëpritura dhe të vlerësuara. Nga ana tjetër studentet thonin se bashkë me mësuesen që i lehtësonte, si dhe me pedagogun mentor realizojnë dhe plotësojnë nevojat për zhvillimin e profesionit.<sup>94</sup></p>

<sup>89</sup> Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL.


<sup>90</sup> Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse.

<sup>91</sup> Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave

<sup>92</sup> Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022.

<sup>93</sup> Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave

<sup>94</sup> Evidenca 1.8.19 Manuali i zhvillimit të praktikave në BAMAP





<b>Konkluzione</b>		GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në mjediset e instituconit rezulton se fakulteti ka mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. <sup>95</sup> Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, po ashtu klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme, teknologjike siç janë videoprojektorët, kompjuterët dhe interneti. Të gjitha mjediset e mësimdhënies kishin ngrohje qendrore dhe ndriçim të mjaftueshëm.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset e tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në mjediset e instituconit rezulton se mjediset mësimore janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke përdorur TIK. <sup>96</sup>
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në mjediset e instituconit rezulton se në mjediset mësimore ku zhvillohet programi i studimit ka pajisje dhe mjetet të nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. <sup>97</sup> Për programin e studimit përdoren 12 salla leksionesh dhe laborator të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe internet.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur	Institucioni zotëron një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale <sup>98</sup> .

<sup>95</sup> Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit; Evidenca 4.7.

<sup>96</sup> Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHE.

<sup>97</sup> Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të FSHE

<sup>98</sup> Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHE.



me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.				
<b>Konkluzione</b>		GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Rezulton se për studentët e këtij programi, institucioni ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale ndërkombëtare <sup>99</sup> , por biblioteka e fakultetit ka në dispozicion literaturë të lidhur drejtpërdrejt me programin e studimit. Studentët kanë në dispozicion një fond të posaçëm të librave për programin e studimit në bibliotekën e fakultetit dhe atë të universitetit. <sup>100</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga bisedat me pedagogët, me studentët dhe me punonjësn e bibliotekës së fakultetit rezulton se institucioni, sipas një plani të detajuar, çdo vit akademik bën pasurimin e saj për të shtuar fondin ekzistues me tituj të rinj, sipas literaturës bazë të çdo lënde të programit <sup>101</sup> . Fondi pasurohej dhe me revista shkencore të edukimit, ku universiteti është abonuar. Evidentohet se ka procedura për pasurimin e fondit të librave çdo vit akademik <sup>102</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në mjediset e fakultetit rezulton se ka një bibliotekën për studentët, të cilët kishin mundësi të studionin, të punonin në kompjuter, si dhe kishte internet gjatë gjithë kohës <sup>103</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo	Rezulton se institucioni ka literaturë dhe fond librash të botuar, si dhe në version elektronik për studentët <sup>104/105</sup> .

<sup>99</sup> Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library

<sup>100</sup> Evidenca 3.8 Fondi i librit.

<sup>101</sup> Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021, Krijimi i fondit të librit;

<sup>102</sup> Evidenca 3.8 Fondi i librit.

<sup>103</sup> Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e FSHE

<sup>104</sup> Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library.

<sup>105</sup> Evidenca 3.8 Fondi i librit.



revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.									
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Evidentohet nga bisedat me studentët se institucioni ka krijuar kushte dhe për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë në bibliotekat fizike dhe online <sup>106</sup> .								
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga biseda me punonjëset e librarisë së fakultetit dhe atë të universitetit rezulton se biblioteka universitare është duke iu nënshtruar procesit të digjitalizimit të saj, nëpërmjet një projekti të bashkëfinancuar nga AKKSHI dhe UNIEL <sup>107</sup> .								
<b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Nga vizita në bibliotekën e fakultetit dhe atë të universitetit pamë se kishte orare të shpallura për shërbimet në to në përshtatje me nevojat e dhe kohën e studentëve, gjë që u konfirmua dhe nga studentët, por dhe nga regjistrimet e tyre në kartelat e bibliotekës <sup>108</sup>								
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga vëzhgimi i librave fizik në bibliotekë konstatohet se ata janë të mirëmbajtur dhe në gjendje për t'u përdorur nga studentët dhe pedagogët. Po ashtu dhe libraria digjitale ishte e përdorshme lehtësisht. Fondi pasurohej çdo vit sipas kërkesave dhe mundësisë, buxhetore, institucionale <sup>109</sup> .								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<sup>106</sup> Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.8 Fondi i librit.

<sup>107</sup> Evidenca 4.9 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIEL.

<sup>108</sup> Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL.

<sup>109</sup> Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021



**Standardi IV.4**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita tek Sekretaria Mësimore, tek Drejtorja e Koordinimit dhe Marrëdhnieve me Jashtë, tek Drejtorja e Kurrikulave dhe Standardeve, tek Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivë së UNIEL rezulton se institucioni zotëron një sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.<sup>110</sup> Nga ana tjetër institucioni nëpërmjet faqes së internetit <a href="http://www.uniel.edu.al">www.uniel.edu.al</a> ofron informacione të detajuara për studentët dhe stafin akademik – administrativ.</p> <p>U vëzhgua se sistemi EMS funksionon si një platformë elektronike nëpërmjet së cilës krijohen, shikohen, përditësohen dhe fshihen të dhëna për personelin e universitetit dhe studentët që ndjekin studimet në Universitet<sup>111</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Rezultoni se institucioni ruan dokumentacionin e tij për personelin akademik, ndihmësakademik, apo për studentët dhe partnerët institucionalë në versionet e printuar dhe online. Në secilën njësi, si: Departamenti, Fakulteti, Universiteti, Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, Drejtorja e Standardeve dhe Kurrikulave, Drejtorja Ekonomike, çdo dokumnet është i ruajtur i printuar dhe online në dosje të veçanta<sup>112</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vëzhgimi i sistemit të menaxhimit evidentohet se personeli akademik dhe studentët kanë mundësi për të ndërvepruar me sistemin e menaxhimit të informacionit, i organizuar në nivel universiteti, fakulteti dhe departamenti, kurse studentët mund të informohen në çdo kohë, on-line dhe pranë sekretarisë së FSHE dhe mund të marrin të gjithë informacionin e kërkuar për programin e studimit. Pedagogët mund të ngarkojnë në sistem materiale ndihmëse për studentët, ndërkohë që studentët mund të kontaktojnë pedagogun e lëndës për çështje akademike, të shkarkojnë materiale studimore të ngarkuara nga personeli akademik. Sistemi disponon të dhëna për orarin e mësimave, stafin akademik, tarifave e shkollimit, etj<sup>113</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module</p>	<p>Nga vëzhgimi i sistemit të menaxhimit evidentohet se ai krijon ndërveprim midis pedagogëve dhe studentëve, si dhe informon për çdo interes të</p>

<sup>110</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.

<sup>111</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS

<sup>112</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL; Neni 69-70, Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.

<sup>113</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS



që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	studentëve. Sistemi EMS përditësohet me informacionet bazë nëse janë regjistruar studentët në lëndët e tyre dhe a kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin. Secili pedagog mund të regjistrohet në sistem në lëndët e veta dhe mund të menaxhonte literaturën e lëndëve përkatëse. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi on-line mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë on-line nëpërmjet Sistemit EMS. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Nëpërmjet EMS, bëhen edhe lajmërimi të përgjithshme në nivel fakulteti ose universiteti <sup>114</sup>								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga vëzhgimi i sistemit të menaxhimit evidentohet se ai funksiononte si një sistem interaktiv online, ku kanë mundësi veprimi personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. Informacioni i vendosur aty dhe ndërveprimi midis pedagogëve dhe studentëve ishte lehtësisht i monitorueshëm dhe shërbente jo vetëm për lehtësimin e komunikimit, por dhe për të analizuar procese të bashkëpunimit dhe me studentët <sup>115</sup> .								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga vëzhgimi i faqes zyrtare, online të institucionit <a href="http://www.uniel.edu.al">www.uniel.edu.al</a> rezulton se aty publikohen informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, të cilat janë të përcaktuara në dokumentet zyrtare të institucionit <sup>116</sup> . Institucioni ka dhe llogaritë zyrtare në rrjetet sociale si: Facebook, Instagram, të cilat shërbejnë si një mjet komunikimi për të publikuar aktivitetet që zhvillohen në UE.								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga shqyrtimi i evidencave dhe nga diskutimi me dekanin dhe përgjegjës të departamentit, si dhe drejtorinë ekonomike rezulton se burimet e financimit të institucionit janë: 1. Financimi nga buxheti i shtetit (Granti për mësimdhënie e transferata tek studentët; Granti konkurrues; Granti për kërkimin shkencor). 2. Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.

<sup>114</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.

<sup>115</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.

<sup>116</sup> Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB



	<p>3. Të ardhurat e vetë institucionit (Pagesat e studentëve për arsimim; Të ardhurat për shërbimet e kryera; Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta)<sup>117</sup>.</p> <p>Rezultoni se nga shqyrtimi i raportit financiar, plani buxhetor vjetor dhe ai afatmesëm është i detajuar në zërat e kostove për programet e cikleve të studimit, ndërsa me propozim të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit miratonte buxhetin afatmesëm dhe vjetor të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij<sup>118</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Rezultoni se Planet vjetore dhe afatmesme, buxhetore me propozim të Senatit akademik miratohen nga Bordi i administrimit, kurse alokimi i burimeve financiare bëhet në përputhje me objektivat që ka secili departament për zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore të UE, duke ndjekur një politikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të shpërndarjes së tyre. Në planet buxhetore evidentohen shpenzime për shërbimin e internetit, për mirëfunksionimin e institucionit për bibliotekën dhe fondin e librave sipas kërkesave të departamenteve<sup>119</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave rezultoni se Institucioni i nënshtrohet çdo vit auditimit<sup>120</sup>, kurse Njësia e Auditimit të Brendshëm realizonte hartimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut dhe në kryerjen e auditimeve në përputhje me planet e miratuara<sup>121</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencës dhe nga diskutimi me Përgjegjës të departamentit rezultoni se institucioni raporton deri në nivel departamenti lidhur me programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës<sup>122</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave dhe nga diskutimi me dekanen dhe përgjegjës të Departamentit konstatohet se institucioni ka garantuar qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit. Procedurat e diskutimit në departament, në fakultet, në rektorat lidhur me kërkesat dhe kapacitetet financiare nëpërmjet analizave dhe diskutimeve kanë mundur qëndrueshmëri dhe miratim fondesh të nevojshme për programin e studimit<sup>123</sup>.</p>

<sup>117</sup> Evidenca 1.14 Rregullore ekonomiko-financiare e UE, neni 4.

<sup>118</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL Neni 26, pika c; Neni 28, pika a;

<sup>119</sup> Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022; Evidenca 1.8.17 Parashikimi i projekt-buxhetit të DMM.

<sup>120</sup> Evidenca 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022).

<sup>121</sup> Evidenca 1.14 Rregullore ekonomiko-financiare e UE, neni 10.

<sup>122</sup> Evidenca 1.8.17 Parashikimi i projekt-buxhetit të DMM.

<sup>123</sup> Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022; Evidenca 4.15 Miratimi i regjistrimit të prokurimeve dhe shërbimeve.



posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.			
<b>Konkluzione</b>	GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Rezulton se institucioni zbatonte procedura ligjore të përcaktuar në aktet e tyre të brendshme, të cilat kishin të bënin me planifikimin e kuotave, regjistrimin, shpalljen e fitueseve, ndjekjen dhe vijimësinë deri në përfundimin e plotë të ciklit bachelor. Programi zgjat 3 vite, me 180 kredite në total <sup>124</sup> . Komunikimi me studentët realizohej nëpërmjet platformës TEAMS <sup>125</sup> . Secili/a student/s është e pajisur me adresën zyrtare në institucione me formatin. “emër.mbiemër @uniel.edu.al”.
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i Statutit të UE, Rregullores së UE dhe FSHE-së rezulton se ato përmbajnë në mënyre të detajuar procedurat dhe praktikatat e regjistrimit, të trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Politikat e hyrjes dhe ato të proceseve në vijim të studimeve garantojnë trajtim të drejtë dhe të barabartë të studentëve bazuar në respektimin e të drejtave duke garantuar barazi gjinore, fetare dhe pa diskriminime racore apo krahinore. Institucioni zbatonj procedura që janë në përputhje me Udhëzimin nr. 10, 15.05.2019, nr.17, 30.07.2019 <sup>126</sup> .

<sup>124</sup> Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit akademik për kapacitetet 2022-2023) dhe miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. (Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL, Kreu VII; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit të studimeve në UE, Kreu II).

<sup>125</sup> Evidencë 4.11 Rregullorja EMS.

<sup>126</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL, Neni 49; Evidenca 1.2, Rregullore e studimeve UNIEL, Neni 14.



<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Rezulton se Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies përcjell në fakjulet dhe më pas fakulteti në rektorat kriteret hyrëse<sup>127</sup> në program, që miratohen në senat dhe që janë në përputhje me udhëzimet e MAS.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Rregullores së UE dhe Rregulloren e Programit rezulton se zbatohen kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku<sup>128</sup>. Nga ana tjetër në sekeretari shënohet progresi i studentëve në çdo semestër me të dhëna të hollësishme mbi ecurinë akademike të studentëve dhe rezultatet e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Nga bisedat me studentë dhe pedagogë rezulton se institucioni përpara fillimit të vitit akademik informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit<sup>129</sup></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencës së kuotave konstatohet se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara<sup>130</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Rezulton se institucioni harton dhe publikon në faqen e tij online, në broshurën e institucionit kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë, për programin e studimit, si:Kandidatët nga trojet; Kandidatët shtetas të huaj; Kandidatët me statusin person me aftësi të kufizuar; Kandidatët me statusin e jetimit; Kandidatët romë dhe ballkano-egjiptianë; Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh; Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi<sup>131</sup></p>

<sup>127</sup> Evidenca 5.1: Vendimi i Senatit akademik për kapacitetet.

<sup>128</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL Kreu VI; Evidenca: Rregullorja e organizimit të studimeve në FSHE, Kreu VI.

<sup>129</sup> Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.

<sup>130</sup> Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.

<sup>131</sup> Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.



<b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Institucioni zbaton politika për studentët e shtresave në nevojë dhe kjo kryhet në fillimin e çdo viti akademik me anë të vendimit të Bordit të Administrimit të universitetit <sup>132</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
				X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga shqyrtimi i Rregullore së Studimeve institucionale, i Rregullores së Programit, Rregullores së fakultetit, i sistemit EMS, i Stendës së Departamentit të Metodologjisë së Mësimdhënies, nga vizita në sekretarinë mësimore rezulton se identifikohet një informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, bazuar në përcaktimet dhe specifikimet e paraqitura në dokumentacionin përkatës <sup>133</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nga takimi me studentët dhe me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë evidentohet se studentët informohen lidhur me njohjen e kualifikimeve të mëparshme <sup>134</sup> . Në takimin me stafin e departamentit konstatohet se ka procedura, ka komision ekuivalentimi për njohjen e krediteve dhe kualifikimeve të mëparshme për studentët ose për programet e dyta të studimit <sup>135</sup> . Studentët merrnin informacionin përkatës në lidhje me procedurat që kryhen përmes koordinatorit të DMM <sup>136</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe me pedagogët evidentohet se studentët njihen që në fillim të lëndës (java e parë) më kriteret e vlerësimit të tyre që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen, frekuentimin, detyrën e kursit, provimin e ndërmjetëm dhe atë final konform Rregullores së

<sup>132</sup>Evidenca 2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet.

<sup>133</sup>Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL; Evidenca 1.8, Rregullore e programit të studimit BAMAP.

Evidencë 1.7, Rregullore e Fakultetit FSHE, Evidencë 4.11: Rregullorja EMS.

<sup>134</sup>Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.

<sup>135</sup>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL, Evidencë 1.2. Rregullore e studimeve UNIEL, kreu VI.

<sup>136</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL nenet 50-54; Evidencë 1.7: Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Edukimit nenet 48-52).



	Programit <sup>137</sup> .			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni ka miratuar dhe formatin e punimit të diplomës <sup>138</sup> dhe e ka publikuar atë. Zakonisht prova finale realizohet me provim, për të cilin studentët orientohen në lidhje me Fondin e pyetjeve të provimit të formimit në fillim të studimeve të vitit të fundit nga pedagogët e departamentit <sup>139</sup> .			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Konstatohet se institucioni promovon programet e tij me anë të: - takimeve të hapura për informimin e maturantëve për programin e studimit <sup>140</sup> . - Spotit online, promovues <sup>141</sup> - Fletëpalosjes promovuese <sup>142</sup> . - Faqes së internetit dhe rrjeteve zyrtare online <a href="https://www.facebook.com/Uniel-Fakulteti-i-Shkencave-te-Edukimit">https://www.facebook.com/Uniel-Fakulteti-i-Shkencave-te-Edukimit</a>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i evidencave dhe nga takimi me studentët evidentohet se ata informohen nga Departamenti javën e parë të vitit të parë të fillimit të studimeve me strukturën e vitit akademik, ku iu detajohen kohëzgjatja e vitit akademik, ndarja e tij në semestra, si dhe periudha e provimeve, u përshkruhet kurrikula dhe u jepet informacion orientues në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e faqes zyrtare të FSHE-së, ndërkohë që një informacion i tillë gjendet edhe në faqen e web-it të UE. Po ashtu studentëve iu bëhen të ditura nga pedagogët elementët e Rregullores së organizimit të studimeve, në lidhje me formën e studimeve,

<sup>137</sup> Evidenca 1.2 Rregullorja e studimeve UNIEL Kreu VI; Evidenca 1.7 Rregullorja e organizimit të studimeve FSHE.

<sup>138</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL.

<sup>139</sup> Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës.

<sup>140</sup> Evidenca 5.2 Kalendar i ditëve të hapura 2022.

<sup>141</sup> Evidenca 5.3 Publikimi i spotit promovues;

<sup>142</sup> Evidenca 5.4 Fletëpalosjet promovuese institucionale.



	kreditet dhe ngarkesën në auditor, vlerën e lëndëve me zgjedhje, frekuentimin dhe format e vlerësimit etj. Gjatë situatës së krijuar nga COVID-19 informacioni i nevojshëm lidhur me lëndët dhe syllabuset përkatës u ofruan edhe online përmes platformës TEAMS. <sup>143</sup>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Nga shqyrtimi i evidencave dhe nga takimi me studentët evidentohet se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionon, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese, si dhe studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të EMS. <sup>144</sup>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi me studentët ata shprehën se Bordi Këshillimor i Biznesit, u jep informacione për kërkesat e punëdhënësve. <sup>145</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Rezultoni se krahas informacionit në fillim të vitit të ri akademik Departamenti i informon studentët në mënyrë të vazhduar në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor shërbimet dhe infrastrukturën për realizimin e tij. Përdoren këtu forma komunikimit me ta, si: Takimi i pare, informues me stafin akademik; Sekretaria mësimore; Faqja zyrtare e FSHE (www.fshe.edu.al); Stenda e informacionit, Monitorët informues, FSHE, kati i 2-të; Dokumenteve të institucionit <sup>146</sup> , si Statuti, Rregullore e studimeve, Rregullore e programit.			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Konstaohet se studentët dhe të interesuarit për programin e studimit marrin informacion të detajuar për programin e studimit nëpërmjet sistemit EMS, si dhe me anë të faqes online të universitetit <sup>147</sup> . Institucioni përdorte dhe platformën TEAMS për një komunikim interaktiv në distancë me studentët nga ana e sekretarisë mësimore, por dhe nga pedagogët gjatë periudhës së COVID -19 <sup>148</sup>			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<sup>143</sup> Rregullorja e studimeve në UE (neni 27).Rregullorja e organizimit të studimeve në FSHE (neni 22). Statuti i UE-së. Evidenca 1.1: Statuti UNIEL, Evidencë 1.2: Rregullore e studimeve UNIEL.Rregullore e FSHE-së. Evidencë 1.8: Rregullore e programit të studimit. Evidenca 6.1 Mesimi online nepermjet Microsoft Teams.

<sup>144</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS).Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB). Evidenca 5.4 - Guida e studentit; Evidenca 1.8.20 Fletë palosje DMM.

<sup>145</sup> Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022).Evidenca 5.5 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit.

<sup>146</sup> Evidencë1.1: Statuti i UE-së. Evidencë 1.2: Rregullore e studimeve UNIEL.Evidencë 1.7 Rregullore e FSHE-së.

<sup>147</sup> Evidenca 4.11 Rregullorja EMS.Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.

<sup>148</sup> Evidenca 6.1:Rregullore e brendshme e UE-së për mbrojtjen nga COVID – 19.Rregullore e posacme e UE-së mbi mënyrën e zhvillimit të provimeve online.



**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Nga takimi me studentët dhe me përfaqësues të Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit konstatohet se ata mbajnë të dhëna për studentët e punësuar dhe ruajën marërdhënie me ta. Të dhënat përditësohen çdo vit. <sup>149</sup>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga takimi në sekretarinë mësimore dhe nga shqyrtimi i evidencave <sup>150</sup> të institucionit evidentohet se ata disponojnë statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Rezulton se institucioni ruan dhe plotëson çdo vit të dhënat statistikore të studentëve me anë të një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse që janë Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. <sup>151</sup>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Konstatohet nga takimi me sekretarinë dhe stafin e departamentit se institucioni realizon monitorime dhe kontrole çdo vit në njësitë përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), por nuk na u ofrua ndonjë dokument evidentues për këtë proces.  <i>Rekomandojmë që fakulteti të zbatojë një plan monitorimi tek sekretaria mësimore, tek sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe ta evidentojë atë me anë të raportit.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe	Nga takimet me sekretarinë mësimore, me Zyrën e Këshillimit, Karrierës dhe Alumnit rezulton se ata kanë të dhëna për studentët

<sup>149</sup> Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/ 2021-2022). Evidenca 1.8.13 Aneks Tabelat përmbledhëse- Tabela 23, të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studenteve.

<sup>150</sup> Evidenca 1.8.13 Aneks Tabelat përmbledhëse- Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studenteve.

<sup>151</sup> Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL.



<p>dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>lidhur profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve<sup>152</sup>. Konstatohet se institucioni harton një raport vjetor ku paraqet cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, por ky proces që ka nisur FSHE duhet që të përmirësohet dhe të ketë një dokumentimin të përditësuar<sup>153</sup> lidhru em punësimin dhe gjurmimin.</p> <p><i>Rekomandojmë zbatimin e një plan veprimi për përditësimin e dokumentacionit të punësimit dhe të gjurmimit të studentëve të punësuar.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p> <p><i>Rekomandojmë zbatimin e një plan veprimi për përditësimin e dokumentacionit të punësimit dhe të gjurmimit të studentëve të punësuar.</i></p> <p><i>Rekomandojmë që fakulteti të zbatojë një plan monitorimi tek sekretaria mësimore, tek sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe ta evidentojë atë me anë të raportit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
		<p>X</p>		

<p><b>Standardi V.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave por dhe nga takimi me studentët rezultojnë se ata ndjehen të përfshirë në jetën e institucionit me anë të përfaqësimit në Senatin Akademik dhe me Këshillin Studentor<sup>154</sup>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim</p>	<p>Nga shqyrtimi i evidencave dhe takimi me student dhe me anëtarë të RVB-së rezultojnë se institucioni garanton përfshirjen e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organizmat e ndryshëm të universitetit, si Senati,</p>

<sup>152</sup> Evidenca 6.3: Pyetësori ALUMNI

<sup>153</sup> Evidencë 1.8.1 Analiza vjetore e DMM; Evidenca 1.8.21 Analiza vjetore e FSHE. Evidencë: Studimi i tregut të punës FSHE

<sup>154</sup> Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL. Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor



apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Këshilli Studentor, Komisionet e RVB-ve, Komisionet e përhershme në fakultet dhe në nivel universiteti, të cilat kanë të dreejtë vendimmarrje <sup>155</sup> .			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga takimi me dekanin dhe me studentë rezultojnë se fakulteti merr mendimin e studentëve rreth kurrikulës së programit të studimit me anë të pyetësorëve, me anë të takimeve të përbashkëta pedagogë-studentë ose vetëm me studentë dhe reflekton interesat dhe idetë e studentëve në programet lëndore <sup>156</sup> .			
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Nga takimi me studentët rezultojnë se në ndonjë rast shumë të rrallë që është kontestuar rezultati/nota e pedagogut, ai/ajo është pritur dhe konsultuar nga pedagogu i lëndës. Vetëm pas këtij komunikimi nota është pasqyruar në sistem. Përpara hedhejs së notave në system, studentët njihem me rezultatet dhe kanë kohë për rishikim ose ankimim të notes, duke bashkëpunuar me pedagogun. Kjo praktikë është e parashikuar dhe në Rregulloren e programit <sup>157</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>

<sup>155</sup> Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL. Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor. Evidenca 5.8 Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional; Evidenca 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; Evidenca 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në Fakultet; Evidenca 5.11 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin BAMAP).

<sup>156</sup> Evidenca 1.8.14 Pyetësor me studentët; Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.

<sup>157</sup> Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga takimi me studentët dhe shqyrtimi i evidencave rezulton se institucioni zbaton procedura dhe ka organizma që janë në funksion të studentëve, si: Sekretaria, Zyra e IT, Zyra e financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI<sup>158</sup>.</p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në Sekretarinë Mësimore evidentohet se çdo student pajiset me një adresë elektronike personale. I gjithë kontakti zyrtar me studentët bëhet përmes adresës elektronike. Gjithashtu, me të njëjtën adresë email-i, studentët mund të hyjnë në EMS. Në javën e parë të çdo viti akademik departamentet organizojnë informimin e studentëve të vitit të parë mbi çështjet administrative nga zyrat kryesore administrative të Universitetit dhe me informacion mbi çështjet akademike të Fakultetit apo departamentit.</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me Njësinë e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rezulton se ata kanë krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila duhet që të përditësohet me të dhëna të sakta çdo vit<sup>159</sup>.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga takimi me Njësinë e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI rezulton se ata gjurmojnë studentët e punësuar dhe kanë krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila duhet që të përditësohet me të dhëna të sakta çdo vit<sup>160</sup>.</p> <p><i>Rekomandojmë zbatimin e një plan veprimi për përditësimin e dokumentacionit të punësimit dhe të gjurmimit të studentëve të punësuar.</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p> <p><i>Rekomandojmë zbatimin e një plan veprimi për përditësimin e dokumentacionit të punësimit dhe të gjurmimit të studentëve të punësuar.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<sup>158</sup> Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL. Evidenca 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL.

<sup>159</sup> Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/ 2021-2022.

<sup>160</sup> Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/ 2021-2022.



## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Rezultoni se institucioni përdor në udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë <sup>161</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Bazuar në evidenca dhe nga takimi me Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë rezultoni se ata zhvillojnë monitorimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ndjekin e zhvillojnë proceset e vetëvlerësimit dhe akreditimit institucional dhe akreditimin e programeve të studimit. Të dhënat e gjetura dhe RVB-të janë pjesë e punës së njëjësive të institucioinit <sup>162</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Rezultoni se Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performancës <sup>163</sup> Të dhënat publikohen në uebsite dhe tek njësitë bazë dhe qendrorelidhur me rezultatet dhe rekomandimet. Ky sektor mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm Sigurimit të Cilësisë në UNIEL dhe nga Komisioni për Sigurimin e brendshëm të Cilësisë në Fakultet <sup>164</sup> .  <i>Rekomandojmë qartësimin dhe zgjidhjen e ankimeve të studentëve lidhur me vlerësimin e tyre me procedura ligjore, të pasqyruara në rregullore përkatëse.</i>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultoni se Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillon pas çdo semestri pyetësorin e studentëve për matjen e performancës <sup>165</sup> .
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	Nga takimi me Sektorin e Kurrikulave dhe Cilësisë dhe nga shqyrtimi i evidencave si raporte të përpunimit të të dhënave nga pyetësorët e studentëve evidentohen praktika dhe shembuj të mirë që janë pjesë e

<sup>161</sup> Evidenca 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams

<sup>162</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 5.9 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL. Evidenca 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet.

<sup>163</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.

<sup>164</sup> Evidenca 5.9 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL. Evidenca 5.10 Urdhri për Komisionet e Përhershme në Fakultet.

<sup>165</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.



përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	mësimdhënies në leksione, seminare, laboratorë, etj, si dhe ato publikohen në faqen zyrtare të institucionit <sup>166</sup> .		
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet kryesisht.</i>  <i>Rekomandojmë qartësimin dhe zgjidhjen e ankimeve të studentëve lidhur me vlerësimin e tyre me procedura ligjore të pasqyruara në rregullore përkatëse.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

## Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Konstatojmë se në institucion funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili planifikon dhe menaxhon proceset e sigurimit të cilësisë me anë të proceseve të vlerësimit të brendshëm institucional dhe atë të programeve të studimit. Materialet e hartuara si raporte apo RVB publikohen në website dhe janë pjesë e punës së departamentit dhe fakultetit <sup>167</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Rezulton se institucioni zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm <sup>168</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve	Konstatojmë se në institucion po punohet në vijimësi për krijimin e një kulture pune, vetëvlerësuese drejt përmirësimit të cilësisë, si dhe i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional dy herë <sup>169</sup> .

<sup>166</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022

<sup>167</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve instiucionalë 2021-2022

<sup>168</sup> Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL, neni 71, neni 24. Evidenca 6.4 Lista e Personelit të Ftuar të angazhuar në FSHE

<sup>169</sup> Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional.



të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.									
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive,	Konstatojmë se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në vazhdimësi përdor standarde, tregues të matshëm zyrtar nga aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, nga Udhëzuesit zyrtar të ASCAL, në proceset e vetëvlerësimit lidhur me hartimin e programeve dhe planeve mësimore								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi VI.3

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëtit.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nga diskutimi me stafin e departamentit dhe nga shqyrtimi i evidencave rezultojnë se ato nën orientimet e Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë zhvillojnë procese vlerësimi dhe dokumentimi të gjetjeve. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, hartohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse, titullarit të lëndës, pedagogëve, për të evidentuar arritjet apo dobësitë e konstatuara, duke synuar përmirësimin e tyre <sup>170</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si	Nga diskutimi me stafin e departamentit dhe nga shqyrtimi i evidencave rezultojnë se Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies zhvillon analiza dhe diskutime për cilësinë e programit të studimit që ofron. Propozimet e tij në lidhje me përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit shqyrtohen së pari nga Dekanati.  Vendimi i Dekanatit mbi propozimet për përmirësimin e programit të studimit dërgohet në Rektorat tek Drejtoria e Standardeve dhe

<sup>170</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.



dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Kurrikulave, e cila ia përcjell më pas Senatit Akademik, i cili merr vendimin përfundimtar në lidhje me përmirësimin e programit të studimit <sup>171</sup> .			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga diskutimi me stafin e departamentit dhe me Njësinë e Sgurimit të Cilësisë, por dhe nga analiza e evidencave rezultojnë se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta të monitorimit si: Vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim i kurrikulës, të të nxënit, vlerësim i provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në shkolla gjatë kryerjes së praktikës, takime të drejtpërdrejta apo plotësim pyetësorësh nga studentë, shqyrtime të kërkesave të studentëve nëpërmjet komisioneve <i>ad-hoc</i> , vlerësime paralele të provimeve, apo marrja e mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve në përfundim të studimeve nëpërmjet pyetësorëve, duke ruajtur privatesinë. Gjetjet dhe rezultatet iu bëhen të njohura njësi bazë dhe asaj qendrore me synimin përmirësimin e vijueshëm të programit dhe bashkëpunimit student-pedagog-student <sup>172</sup> .			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Evidentojmë se institucioni ka ngritur dhe funksionojnë organizmat si: Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, organizma që zhvillojnë procese vlerësimi dhe matje të performancës, por dhe sigurojnë dhe përpunojnë të dhëna për punësimin dhe gjurmimin e studentëve të diplomuar <sup>173</sup> .			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<sup>171</sup>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.

<sup>172</sup>Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.

<sup>173</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021; 2021-2022.



**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga takimi me Dekanin, me Përgjegjës të departamentit, me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, por dhe nga shqyrtimi i evidencave rezulton se konform strukturës zyrtare, institucionale, njësitë e institucionit planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <sup>174</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Nga shqyrtimi i rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Institucionit evidentohet se universiteti përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për të gjitha palët e përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit si dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave, në përputhje me standardet shtetërore <sup>175</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Nga takimet me stafin e programit dhe me studentë konstatojmë se Departamenti si njësi bazë është i përfshirë aktivisht në proceset e sigurimit të cilësisë me anë të përgatitjes së RVB-së, që nënkupton shumë procese vlerësimi, procese të shkruari, analize dhe përpunimi të dhënash dhe daljen me një produkt final, si RVB. Evidentojmë se Departamenti ka të ngritur njësinë e sigurimit të cilësisë së brendshme me veprim të përhershëm me 3-5 anëtarë, në të cilën përfshihen anëtarët e departamentit dhe të paktën 1 student, njësi që monitoron organizimin dhe format e mësimdhënies, cilësinë dhe kontrollin e njohurive <sup>176</sup> .
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi	Nga diskutimi me pedagogët, me studentë, por dhe nga shqyrtimi i evidencave rezulton se proceset e vlerësimit të brendshëm garantojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Ato sigurojnë shanse për një pjesëmarrje të drejtë të personelit akademik, ndihmës akademik e të studentëve në procesin e vlerësimit të brendshëm. Procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UNIEL <sup>177</sup>

<sup>174</sup> Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL, neni 71, neni 24; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe Funksionimit UNIEL, neni 18; Evidenca 5.9 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; Evidenca 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet.

<sup>175</sup> Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe Funksionimit UNIEL; Evidenca 5.9 Urdhri për Komisionet e Përhershme Institucionale në UNIEL..

<sup>176</sup> Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit BMAP.

<sup>177</sup> Rregullorja e UNIEL, Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL, Rregullorja e FSHE-së Evidenca 1.7 Rregullore e organizimit të studimeve në FSHE, Evidenca 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL..



apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.									
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Konstatojmë nga bisedat me stafin se në proceset e vetëlerësimit përfshihen dhe pedagogë më kohë të pjeshme, të cilat ishin prezent dhe në takimet tona, si dhe ata shprehen se ftohen dhe diskutojnë në departament rreth përmirësimit të programit dhe proceseve të mësimdhënies.								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Konstatojmë se në institucion funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili planifikon dhe menaxhon proceset e sigurimit të cilësisë me anë të proceseve të vlerësimit të brendshëm institucional dhe atë të programeve të studimit. Materialet e hartuara si raporte apo RVB publikohen në website dhe janë pjesë e punës së departamentit dhe fakultetit <sup>178</sup> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga diskutimi me stafin e departamentit dhe nga shqyrtimi i evidencave rezultojn se ato nën orientimet e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë zhvillojnë procese vlerësimi dhe dokumentimi të gjetjeve Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, hartohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse, titullarit të lëndës, pedagogëve, për të evidentuar arritjet apo dobësitë e konstatuara, duke synuar përmirësimin e tyre, por gjithnjë duke respektuar etikën dhe lirisë akademike <sup>179</sup> .
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan	Konstatojmë se Njësia e Sigurimit të Cilësisë informon njësitë bazë dhe atë qendrore lidhur me rezultatet e vlerësimit me anë të raporteve vjetore, ku

<sup>178</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022.

<sup>179</sup> Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022. Evidenca 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL.



masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	paraqitet metodologjia e zbatuar, gjetjet, rezultatet dhe rekomandimet, pro dhe sugjerime për njësinë bazë dhe qendrore lidhur me zbatimin e një plani përmirësimi për rekomandimet e sugjeruara <sup>180</sup>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatojmë se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në vazhdimësi përdor standarde, tregues të matshëm zyrtar nga aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, nga Udhëzuesit zyrtar të ASCAL, në proceset e vetëvlerësimit lidhur me hartimin e programeve dhe planeve mësimore të disiplinave mësimore si edhe harmonizimin e tyre, duke përdorur metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve <sup>181</sup> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Konstatojmë se Njësia e Sigurimit të Cilësisë zhvillon takime me njësinë bazë lidhur me ndryshimet apo risitë në dokumentet e vetëvlerësimit. Nga ana tjetër Universiteti zbaton çdo vit trajnime për zhvillimin profesional që prekin tematika të vlerësimit të brendshëm, por dhe tematika që lidhen kryesisht me metodologjinë e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të institucionit në të gjitha nivelet (departament, fakultet, rektorat). Theksojmë dhe mobilitetet e ofruara për pedagogë dhe studentë të mbështetur financiarisht nga ERASMUS + janë një kontribut i vyer <sup>182</sup> . Institucioni mundëson botime artikujsh në revistat e saj shkencore dhe për studentë dhe pedagogë sëbashku, sipas mundësive të tyre.			
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ shprehet se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotërisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Plotërisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<sup>180</sup> Evidenca 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL

<sup>181</sup> Evidenca 6.3 Urdhrat për zhvillim e pyetësorëve institucionale 2021-2022. Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022.

<sup>182</sup> Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve FSHE.




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

- Programi i studimit BA në Arsim Parashkollor i zbatuar në Universitetin e Elbasanit që nga viti akademik 1995-1996, prej një periudhe 27 vjeçare, dëshmon qartë konsolidimin e tij dhe funksionon në harmoni të plotë me vizionin, misionin dhe planin strategjik të Universitetit, me strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamentit të Metodologjisë së Mësimdhënies, si dhe në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe aktet rregullatore në fuqi duke u orientuar në këtë mënyrë drejt përmirësimit me realizëm të institucionit në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe duke i shërbyer në këtë mënyrë cilësisë në rritje të vetë programit.
- Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor ka një kurrikul bashkëkohore të përgatitur me shumë kujdes, me qëllim plotësimin e kërkesave të studentëve për njohuri bashkëkohore në fushën e mësuesisë.
- Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies ka treguar në vazhdimësi se ka kapacitete dhe përvojën akademike, profesionale dhe logjistike për të zhvilluar me sukses programin Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, duke dëshmuar traditën dhe qëndrueshmërinë e këtij program studimi.
- Stafi akademik i angazhuar për të dhënë mësim në këtë program studimesh përbëhet nga ekspertë të fushës me tituj/grada shkencore dhe me një përvojë të suksesshme jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në angazhime të tjera institucionale.
- Fakulteti disponon laboratorë funksionalë të arteve, të informatikës që ndikojnë në një formimin tërësor të studentëve të programit Bachelor në Arsim Parashkollor.
- NJSBC dhe GVB sigurojnë një monitorim të qëndrueshëm të cilësisë së programit të studimit dhe pasqyruim të rezultate konkrete të arritjes së objektivave për programin e studimit

**Pika të dobëta**

- Rritja e fondeve për kërkim shkencor.
- Nivel jo i mirë i përfaqësimit në projekte ndërkombëtare që lidhen me fushën e studimit
- Mungesë e përcaktimit të detyrave të koordinatorit të programit të studimit në aktet rregullatore institucionale.






## **Rekomandime**

- Rekomandojmë plotësimin e Rregullores së FSHE-së dhe Rregullores së DMM-së me nenin mbi pozicionin e Koordinatorit të Programit të Studimit.
- Rekomandojmë që raporti i analizës së pyetësorëve të përfshihet në dokumentet e dorëzuara nga Departamenti që mbulon programin dhe të botohet në faqen zyrtare të Universitetit të Elbasanit.
- Rekomandojmë që në disa programe lëndore, të rishikohet raporti i vlerësimit të provimit përfundimtar të studentëve me atë të vlerësimit të vazhduar dhe ky raport të jetë sipas përcaktimeve të bëra në Rregullores së studimit në FSHE.
- Rekomandojmë që fakulteti të zbatojë një plan monitorimi tek sekretaria mësimore, tek sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe ta evidentojë atë me anë të raportit.
- Rekomandojmë zbatimin e një plan veprimi për përditësimin e dokumentacionit të punësimit dhe të gjurmimit të studentëve të punësuar.
- Rekomandojmë qartësimin dhe zgjidhjen e ankimeve të studentëve lidhur me vlerësimin e tyre me procedura ligjore të pasqyruara në rregullore përkatëse.

## **Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor 'Preschool Education' provided by the Higher Education Institution 'University of Elbasan'**

### **Strengths and Affirmations:**

- The BA study program in Preschool Education implemented at the University of Elbasan since the academic year 1995-1996, from a period of 27 years, clearly proves its consolidation and works in full harmony with the vision, mission and strategic plan of the University, with the development strategy of the Faculty of Education Sciences, the Department of Teaching Methodology, as well as in accordance with the Law on Higher Education as well as the regulatory acts in force, being oriented in this way towards the realistic improvement of the institution in the national and international context and thus serving the increasing quality of the program itself.
- The Bachelor's study program in Preschool Education Teacher has a contemporary curriculum prepared very carefully, with the aim of meeting the demands of students for contemporary knowledge in the field of teaching.
- The Department of Teaching Methodology has continuously shown that it has the academic, professional and logistical capacities and experience to successfully develop the Bachelor's program in Teacher for Preschool Education, proving the tradition and sustainability of this study program.
- The academic staff engaged to teach in this study program consists of experts in the field with scientific titles/degrees and with a successful experience not only in teaching, but also in other institutional engagements.
- The faculty has functional arts and informatics laboratories that influence the overall formation of the students of the Bachelor's program in Preschool Education.
- NJSBC and GVB ensure a sustainable monitoring of the quality of the study program and reflection of the concrete results of achieving the objectives for the study program






## **Weakness**

- Increasing funds for scientific research.
- Poor level of representation in international projects related to the field of study
- Lack of defining the duties of the study program coordinator in the institutional regulatory acts.

## **Recommendations**

- We recommend supplementing the FSHE Regulation and the DMM Regulation with the article on the position of Study Program Coordinator.
- We recommend that the questionnaire analysis report be included in the documents submitted by the Department covering the program and published on the official website of the University of Elbasan.
- We recommend that in some subject programs, the evaluation report of the students' final exam be reviewed with that of the continuous evaluation and that this report be according to the determinations made in the Study Regulations at FSHE.
- We recommend that the faculty implement a monitoring plan at the teaching secretariat, at the internal information management system and document it through the report.
- We recommend implementing an action plan for updating employment documentation and tracking employed students.
- We recommend the clarification and resolution of student complaints regarding their assessment with legal procedures reflected in the relevant regulations.





Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X